



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi në parim i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Kulturës.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Besnik Baraj (deputet zëvendësues)

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Mirela Kumbaro – Ministre e Kulturës,

Eridana Zoto – përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit të Drejtorisë së Buxhetit të Ministrisë së Kulturës,

Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Jemi në seancën e radhës për të dëgjuar opinionet e Ministrisë së Kulturës lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019, për të ndarë me ta nëse ky projektbuxhet arrin të realizojë të gjitha objektivat që ato kanë për vitin ushtrimor 2019.

Për këtë arsye kemi marrë paraprakisht edhe një dokument të përgatitur nga vetë ministria lidhur me buxhetin, por përpara se të fillojmë të dëgjojmë zonjën Mirela Kumbaro, ministren e Kulturës, e cila ka ardhur këtu për të prezantuar buxhetin, unë do t'ia jepja fjalën zotit Ylli për të na thënë nëse e kemi apo jo kuorumin për ta zhvilluar mbledhjen e sotme.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë. Ne jemi dhjetë anëtarë të komisionit, por unë përsëri vazhdoj të ndiej keqardhje për opozitën, e cila për një gjë kaq të rëndësishme, siç është buxheti, përsëri bojkoton dhe nuk vjen. Por ne do të vazhdojmë punën tonë.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Ylli!

Zonja Ministre, ju lutem, na bëni një shpjegim për projektbuxhetin e vitit 2019.

Fjala është për ju.

Mirela Kumbaro – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Të nderuar kolegë,

Sigurisht, është nder, por edhe një përgjegjësi shumë e madhe për Ministrinë e Kulturës që vjen në prezantimin e buxhetit të qeverisë për kulturën për vitin 2019. Është nder dhe përgjegjësi, sepse, në fakt, të mbrosh buxhetin e gjashtë në menaxhimin e politikave kulturore do të thotë se është bërë tashmë një rrugë e gjatë në ndërtimin e sistemit të administrimit të sektorit publik të kulturës. Natyrisht, pas pesë vjetësh, dhe kur përgatitemi për vitin e gjashtë, analiza nuk bëhet më se si e gjetëm, por se sa kemi ecur dhe ku duam të mbërrijmë, ndonëse nuk duhet harruar asnjëherë se në çfarë derexheje ishte ky sektor në vitin 2013. Por në këta pesë vjet standardet e punës dhe të projekteve janë vendosur dhe sfidën tashmë e kemi me veten tonë për të qenë në lartësinë e organizatës ku duam të integrohemi, në Bashkimin European, por edhe të pritshmërive të publikut, që, në fakt, me të drejtë, ecin më shpejt se punët tona.

Nëse ka një mësim që del në krye të pesë vjetëve, është që sa më shumë të bëjmë, sa më mirë të bëjmë, aq më të mëdha janë pritshmëritë dhe, në fakt, pritshmëritë janë gjithnjë e më të mëdha sesa nga ajo që ne arrijmë të bëjmë. Prandaj, sfida mbetet shumë e madhe.

Në mandatin tonë të parë treguam se arritëm ta nxjerrim kulturën nga gropa e borxheve dhe gjendja e emergjencës, duke e kthyer atë në prioritet, në motor zhvillimi dhe në pasaportë kombëtare. Mori fund. Por edhe në vitin e parë të këtij mandati të dytë treguam shumë qartë se ne kemi prioritete tashmë të stabilizuara.

Gjatë viteve 2013-2018 u synua dhe u arrit të konsolidohej, madje të përmirësohej, struktura muzeale, të hapeshin katër objekte të reja me karakter muzeal dhe, pavarësisht fondeve të limituara të buxhetit të Ministrisë së Kulturës, u arrit të ngriheshin fonde me partnerë strategjikë disafish më të larta sesa perioda 2005-2013, dedikuar trashëgimisë kulturore materiale dhe asaj jomateriale. Nga ana tjetër, rigjallërimi i institucioneve të artit dhe të kulturës gjatë këtyre viteve zgjoi interesin e njerëzve ndaj aktiviteteve kulturore, si dhe e ktheu kulturën edhe në vëmendje të debatit publik, por, për fat të mirë, në fund edhe të debatit politik.

Gjithashtu, në sajë të angazhimit të veçantë, janë ngritur fonde dhe janë planifikuar projekte e investime konkrete në të gjitha rajonet e Shqipërisë për Ministrinë e Kulturës, nëpërmjet koordinimit të disa sektorëve strategjikë të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe të partnerëve. Veçoj këtu bashkëpunimin tejet të frytshëm me Fondin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, Delegacionin European në Shqipëri, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, Bankën Botërore e të tjerë.

Si pjesë e programit buxhetor afatmesëm, kërkesat buxhetore sipas zërave të projektbuxhetit të vitit 2019, krahasuar me buxhetin e vitit 2018, paraqiten si më poshtë.

Buxheti total për vitin 2019, i parashikuar, është në vlerën 2 miliardë e 165 milionë e 867 mijë lekë, ku, krahasuar me vitin 2018, kemi një rritje prej 0,8%. Nisur nga treguesi i mësipërm, unë mund t'juja citoj edhe më të detajuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesa për pagat dhe sigurimet shoqërore është rritur me 3%. Në fakt, nuk është se ka rritje të fondit të pagave, por vetëm indeksim.

Shpenzimet korrente, që janë shumë të rëndësishme për ne dhe do t'juja shpjegoj pak më vonë pse, janë rritur në masën 12%, ndërsa shpenzimet nga të ardhurat, që gjithashtu kanë një vlerë tejet të rëndësishme (do ta shpjegoj në vijim edhe këtë) kanë rritje prej 17%. Në total, krahasuar me vitin e kaluar, buxheti është rritur me 8%. Nisur nga treguesit e mësipërm, projektbuxheti i vitit 2019, krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2018, ka një rritje prej 156 milionë lekësh, nga të cilat 55 milionë lekë shkojnë për investimet, ndërsa në korrente janë 101 milionë lekë, ku për t'u theksuar është rritja e shpenzimeve nga të ardhurat prej 31 milionë

lekësh, si rezultat i rritjes së të ardhurave të këtij viti, si dhe plotësim në nevojë i mirëmbajtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore.

Vlen gjithashtu të theksohet se kjo rritje tek të ardhurat do të shkojë e gjitha për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, duke e sjellë kështu punën me pasurinë kulturore në atë që është thelbi i vetë restaurimit, të mirëmbajtja.

Jemi mësuar, në fakt, në gjithë këto vite që, kur flasim për restaurime, të mendojmë vetëm kantierë të mëdhenj, ku u hyn gjërave me themel. Në fakt, jeta dhe standardi i restaurimit nuk është që rregullisht ta fillosh një punë nga e para, por zemra e restaurimeve dhe e ruajtjes së trashëgimisë kulturore është mirëmbajtja, si në çdo shtëpi. Mirëpo kur mirëmbajtja çalon për dekada të tëra, sikurse ka ndodhur të paktën në tri dekada, pastaj detyrohem të rikuperojmë vlera të humbura, detyrohem të bëjmë restaurime me themel, ku kostoja është më e lartë.

Në qoftë se në tri dekada do të ishte vazhduar të mirëmbahej rregullisht çdo vit inventari i pasurisë kulturore, nuk do të ishim sot në situatën ku në tridhjetë vjet, sidomos në fund të viteve '90, të humbim mbi 100 objekte, madje të zhdukeshin krejt nga harta e Shqipërisë, dhe ku mbi 200 objekte të tjera të ishin shumë rëndë të rrezikuara, gati të shkatërruara.

Kjo është arsyeja pse kemi folur gjithmonë për një punë frontale dhe për situata emergjence. Ndërkohë, kemi arritur tashmë t'i rikthehem ritmit të mirëmbajtjes, por duke ruajtur edhe prioritetet për ato objekte që vazhdojnë të jenë ende të rrezikuara. Sepse në një total inventari mbi 2480 objekte të inventarit të pasurive kulturore, sigurisht nuk mjaftojnë as një, as dy, as katër vjet për ta sjellë situatën në atë standard që do të dëshironim të kishim, sikurse këto tridhjetë vjet të mos kishin rrjedhur, siç rrodhën, pa asnjë vëmendje për trashëgiminë kulturore.

Ndërkohë, po paraqesim, gjithashtu, projektbuxhetin për vitin 2019, krahasuar me atë të vitit 2018, siç edhe e shikoni, rregullisht i referohem vitit të fundit dhe jo tashmë të gjitha viteve të mëparshme, pasi besoj që është i qartë tashmë hopi cilësor i kryer, sipas programeve buxhetore të Ministrisë së Kulturës.

Për vitin 2019, në planifikim-menaxhim, buxheti është 160 milionë e 276 mijë lekë. Në zërin “trashëgimitë kulturore dhe muzetë” janë 522 milionë e 191 mijë lekë; në “art dhe kulturë”, ku kemi një rritje të ndjeshme, janë 1 miliard e 483 milionë e 400 mijë lekë, duke pasur parasysh që këtu do të shkojë këtë vit prioritet investimi për përfundimin e fazës së dytë dhe të tretë të kantierit të Teatrit të Operas dhe Baletit, që është edhe investimi më madhor që është kryer në këta pesë vjet në fushën e artit dhe të kulturës, por jo vetëm në këta pesë vjet.

Është absolutisht investimi më i madh që është bërë në fushën e artit në tridhjetë vjetët e fundit me projektin e realizimit të Teatrit të Operas dhe Baletit, i cili qysh kur është ndërtuar, në fillim të viteve '60, nuk është prekur më me dorë, madje më lejoni t'ju kujtoj se ky është fati i të gjitha institucioneve të mëdha kombëtare, për të cilat, qysh kur janë ndërtuar, nuk ka pasur më asnjë investim, përfshirë Muzeun Historik Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare, Galerinë Kombëtare e kështu me radhë, të gjithë muzetë kombëtarë, teatrin po se po, sepse qëkur u ndërtua në '30-ën, nuk pa më investim me sy.

Ndërkohë, planifikimi i shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore për këtë vit që shkoj janë plotësuar në masën 100% në buxhetin e vitit 2019, pa asnjë mangësi, problem që e patëm në vitin 2018.

Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë do ta përballojnë të gjithë volumin e punës me të njëjtin numër punonjësish dhe të njëjtin fond page. Nuk do të ketë shtesa në vende pune, por do të ketë shtesa në programe. Ne parashikojmë që për vitin 2019 të krijojmë një institucion të ri kombëtar për t'u dhënë përparësi politikave në fushën e librit, edukimit dhe leximit, pra do të krijojmë Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, e cila do të jetë një agjenci në nivel kombëtar, për të ekzekutuar në territor të gjitha politikat dhe programet e Ministrisë së Kulturës, të cilat ne i kemi ngritur tashmë dhe kanë hyrë në vitin e tyre të katërt të zbatimit, por gjykojmë se Ministria e Kulturës duhet të merret edhe më shumë me politikat dhe konceptimin e programeve të reja, ndërsa si agjenci zbatuese e këtyre politikave do të jetë pikërisht Qendra Kombëtare e Librit, e cila do të merret kryesisht me programe edukimi, me promovimin e letrave shqipe, me nxitjen e leximit, si një mjet i domosdoshëm për edukimin dhe emancipimin e shoqërisë, si dhe për të zënë kohën që, për fat të keq, shpeshherë deri sot shumë nga të rinjtë e kalonin në lotosportet apo në lojërat e fatit, të cilave tashmë u kemi dhënë një përgjigje.

Trashëgimia kulturore, që zë gjithmonë pjesën e luanit në punën e Ministrisë së Kulturës dhe që shtrihet në të gjithë territorin, është një potencial i jashtëzakonshëm ende i pashfrytëzuar plotësisht. Kthimi i saj në destinacionin gjithëvjetor turistik dhe nxitës për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik kërkon ruajtjen dhe rehabilitimin e vlerave të saj. Kombinimi i programit të rilindjes urbane me atë të restaurimit dhe të rijetëzimit të qendrave historike është një model suksesi. Ky kombinim, i filluar në vitin e parë të mandatit tonë të dytë, me programin "100 fshatra", do të vazhdojë për të kaluar në atë që e kemi quajtur rilindja rurale, ku komponenti kulturor luan një rol tejet të rëndësishëm.

E pra, qëllimi ynë është të vazhdojmë ende në këto ritme nëpërmjet PBA-së së vitit 2019-2021 me restaurimet dhe rijetëzimin e qendrave të tjera historike dhe monumenteve të kulturës, që kanë një potencial të vlerësuar për turizmin kulturor.

Procesi i mirëmbajtjes për konservimin e trashëgimisë kulturore është, siç e thashë, proces i rëndësishëm dhe, në fakt, po ta shikojmë, vetëm gjatë vitit 2018 kemi kryer punime mirëmbajtjeje për mbi 170 monumente kulture, si: banesa, objekte kulti, kala e të tjerë. Për këtë arsye, prioritetet për shpenzimet korrente do të përqendrohen te mirëmbajtja e monumenteve të kulturës, sipas listës së emergjencës së gjendjes së tyre fizike.

Edhe një herë, dua të theksoj një aspekt tejet të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore. Qëllimi nuk është vetëm të krenohemi me trashëgiminë kulturore, por synimi është ta kthejmë atë në një vlerë ekonomike, në burim zhvillimi ose, siç është slogani ynë: “Trashëgimia kulturore – motor zhvillimi” dhe, në fakt, një ndër elementet treguese të kësaj arritjeje është pikërisht vizitueshmëria në institucionet kulturore, në sitet e trashëgimisë, në muzetë, që për periudhën janar – shtator ka qenë spektakolare, krahasuar jo me vitin 2013, me të cilin nuk bëhet më dot krahasimi, por me vitin 2017.

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë nëntëmuajorit janar-shtator 2018 janë vizituar nga 864711 vizitorë vendas dhe të huaj, nga të cilët 253659 në muzetë kombëtarë, 340819 në parqet arkeologjike dhe 270233 në monumentet e kulturës. Kjo deri në datën 30 shtator, ndërkohë që edhe muaji tetor ka qenë po kaq befasues, sezoni turistik vazhdon, madje ka qenë më i gjati krahasuar me të gjitha vitet e tjera të mëparshme.

Për t’ju dhënë vetëm një shembull, do t’i rikthehem Gjirokastrës, ku ka pasur vërtet një bum të jashtëzakonshëm dhe ku, për të parën herë, vizitorët kanë mbajtur radhë për të vizituar kalanë. Nga 1 janari deri më 30 shtator kishim mbi 110 mijë vizitorë. Ju kujtoj se i gjithë viti 2013 shënoi vetëm 6900 vizitorë, ndërsa në vitin 2017 kemi pasur 72 mijë vizitorë për të gjithë vitin.

Por do t’i shikojmë në fund të këtij viti rezultatet, duke shkuar kështu drejt objektivit tonë të këtij mandati për një turizëm gjithëvjetor.

Ndërkohë, ajo që është interesante për t’u shpjeguar është se vizitorët shoqërohen edhe me rritjen e të ardhurave, që vijnë nga institucionet e trashëgimisë kulturore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi trefishim të të ardhurave nga institucionet e trashëgimisë kulturore. Kjo do të thotë se trashëgimia kulturore e meriton jo vetëm, sepse është kulturë kombëtare, por sepse meriton të ketë mbështetje, si dhe të ketë investim arti dhe kulture, pasi ka ditur ta kthejë në

motor zhvillimi edhe aty ku nuk janë bërë investime, por ku është bërë vetëm mirëmbajtja nga Ministria e Kulturës dhe ku është bërë mjaft fort promovim. Kjo është arsyeja pse na ndihmon qeveria sivjet, sepse një pjesë e madhe e shpenzimeve të ardhura edhe nga biletat i rikthen në sitet e trashëgimisë kulturore për të përmirësuar mirëmbajtjen dhe shërbimin. Natyrisht, kjo ka shkuar me një paketë shumë të fortë në promovim.

Kalendari artistiko-kulturor i turizmit, që ne ndërtuam nga 1 maji deri në 30 shtator, ishte një ndihmë jashtëzakonisht e madhe jo vetëm për të shtuar vizitorët, por për të rritur turizmin në të gjithë Shqipërinë.

Po të shikojmë shifrat, gjatë tre muajve kulminantë të sezonit turistik, rreth 20% e turistëve që kanë hyrë në Shqipëri kanë qenë me destinacion kulturor në sitet e trashëgimisë. Kjo do të thotë se kemi një potencial të jashtëzakonshëm në këto site dhe në përgjithësi në të gjithë sektorin e kulturës për ta përdorur atë si një ndër burimet e rëndësishme të zhvillimit ekonomik.

Praktikisht numri i aktiviteteve të organizuara specifikisht nga Ministria e Kulturës gjatë gjithë sezonit turistik, por edhe në koordinim me Ministrinë e Turizmit dhe atë të Bujqësisë, na çoi në rreth 500 aktivitete gjatë sezonit turistik, që i bie gati 3 aktivitete çdo ditë në të gjithë Shqipërinë, ndërsa nga ato të organizuara vetëm nga Ministria e Kulturës kishim çdo ditë 1,5 aktivitete gjatë gjithë sezonit turistik për të gjitha kategoritë, për të gjitha grupmoshat, si dhe për të gjitha shijet, duke filluar që nga Teatri i Operas dhe Baletit që kësaj vere pushtoi sheshet dhe plazhet, deri te programet për fëmijë.

Në diplomacinë kulturore ne shënuam jo pak suksese. Dua të veçoj këtu të paktën dy projekte shumë të rëndësishme, siç ishte Panairi i Librit në Lajpcig, ku Shqipëria ishte praktikisht vendi përfaqësues i të gjitha vendeve të Europës Juglindore, dhe Bienalja e Venecias, ku Shqipëria u prezantua me projektin “Tirana zero space”, që gjithashtu ishte një projekt, i cili mbyllet vetëm pas dy javësh pas gjashtë muajsh suksesi. Gjithashtu, vlen të shënohet që gjysma e dytë e vitit 2018, gjatë së cilës Ministria e Kulturës celebroi edhe konferencën “Shqipëria, 60 vjet në UNESCO”, do të ndiqet javën që vjen me një event të jashtëzakonshëm në Paris, ku do të hapim ekspozitën e ikonave në selinë e UNESCO-s. Besoj se do të jetë një ngjarje e veçantë jo vetëm për vendin, por edhe për vetë organizatën ndërkombëtare në fjalë.

Ndërkohë, po përgatitemi që edhe në dy muajt e fundit të vitit të kemi dy evente të rëndësishme, edicionin e katërt të festivalit “Legjendat shqiptare – novelat grafike”, që zhvillohet në kuadër të Vitit të Skënderbeut. Dua të theksoj këtu që Ministria e Kulturës ka qenë në pararojë të aktiviteteve të Vitit të Skënderbeut qoftë për sa u përket mirëmbajtjes dhe

restaurimeve të disa objekteve të shënuara në kalendarin e aktiviteteve për Vitin e Skënderbeut, duke nisur që nga muzeu i Kastriotëve në Sinë të Dibrës, që në fakt solli në vëmendjen e publikut jo vetëm ekzistencën e një destinacioni të ri turistik, por solli në vëmendje të gjithë krahinën e Dibrës si një destinacion i jashtëzakonshëm kulturor dhe turistik, i cili paralel me ndërtimin e Rrugës së Arbrit, do të jetë një ndër zbulimet e reja në vitet që vijnë për turizmin dhe për agroturizmin.

Po kështu, kam dëshirë të ndaj me ju lajmin, që jemi në përfundim të kantierit tjetër të Vitit të Skënderbeut që është memoriali i Skënderbeut dhe kisha e Shën Nikollës në Lezhë, e cila është rehabilituar tërësisht në një koncept të ri arkitekturor, i cili do të jetë patjetër një destinacion i ri turistik i rivlerësuar, por jo vetëm kaq. Kujtoj këtu që asnjëherë nuk është vlerësuar në të dhe ne e kemi parashikuar ta inaugurojmë në Samitin e Dytë të Diasporës që do ta zhvillojmë në 2 mars, ku Lezha do të jetë një destinacion shumë i rëndësishëm i këtij samiti.

Programi “Rrugët e besimit” që konsiston në itineraret turistike, e kemi prezantuar edhe në programin e qeverisë në krye të këtij mandati, që vlerësojnë bashkekzistencën fetare dhe, sidomos një aset shumë të jashtëzakonshëm të artit dhe të kulturës. Të mos harrojmë kishat bizantine, që janë fillesa e arteve pamore shqiptare. Nxjerrja në pah e tyre vlen jo vetëm për të shpëtuar dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore, por edhe për të treguar historinë e artit tonë kombëtar. Në këtë kuptim, në vitin 2017 ne kemi hapur 33 kantiere të trashëgimisë kulturore, një pjesë të rëndësishme të të cilave e përbëjnë objektet e kultit, teqetë, kishat dhe xhamitë, të cilat do të vazhdojnë edhe në vitin 2019. Kemi në punë e sipër edhe një operacion shumë të rëndësishëm shpëtimi, ku meriton një falënderim të jashtëzakonshëm profesor Aleksandër Meksi dhe profesor Pirro Thomo, të cilët kanë qenë mbështetje për Manastirin e Shënkollit në Mesopotam, në bashkinë Finiq dhe kisha e Shën Mërisë në Peshkëpinë e Sipërme, në Dropull, të cilat ishin dy objekte shumë të rrezikuara.

Kemi nxjerrë nga rreziku një tjetër kishë të jashtëzakonshme, kishën e Ristozit në Mborje dhe po kështu, jemi në kantier e sipër të dy kishave, të cilat po i bëjmë në bashkëpunim edhe me Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare, në Libofshë të Fierit (kishën e Shën Gjergjit dhe kishën e Shënkollit).

Vazhdon puna në dy qendra historike në Dhërmi dhe në Vuno, të cilat synojmë t'i bëjmë gati në sezonin e ardhshëm turistik.

Kanë nisur dy projekte të reja, të cilat do të finalizohen në fazën e projektzbatimit për vitin 2019. I pari është projekti i rehabilitimit, i rikonceptimit dhe i rifunksionalizimit të

Muzeut Historik Kombëtar, i cili është muzeu i fundit i ndërtuar para vitit 1990, në vitin 1981, i cili që atëherë nuk ka njohur që atëherë asnjë investim serioz. Ju konfirmoj me shumë keqardhje se ky institucion është në një gjendje shumë të rëndë fizike, për sa i përket vetë konstruksionit, me hapësira të tëra prej qindra metrash katrorë të pashfrytëzuara, ku i gjithë sistemi i klimatizimit, i lagështisë, i temperaturës, është krejt jashtë funksionit duke u kthyer në një serë e tmerrshme në verë dhe në akull në dimër, ku fondet janë në kushte shumë të këqija ruajtjeje dhe mirëmbahen vetëm nga vullneti i punonjësve, pa folur këtu për cilësinë e materialeve të përdorura, që po të kemi parasysh vitet '80, nuk kanë qenë më të mirat. Ajo që mua më duket më shqetësuese dhe e bën të domosdoshëm rikonceptimin e itinerarit muzeor të këtij institucioni shumë të rëndësishëm për muzetë në Shqipëri, është vetë mënyra e të treguarit të historisë, e cila vuan nga ideologjizimi shumë i thellë i narrativës, që sigurisht justifikohet me diktatin e kohës, por ne nuk mundemi në vitin 2018 dhe 2020, të vazhdojmë t'u tregojmë fëmijëve dhe vizitorëve historinë, që nuk e kemi dhe gropa të tëra të zeza të historisë, që mungojnë. Kjo është arsyeja pse, megjithëse është një projekt shumë i guximshëm, një sfidë shumë e madhe, një barrë shumë e madhe, që mbase ka një arsye që në këto 30 vjet, ndonëse është thënë, nuk është ndërmarrë ndonjëherë për t'u përballur me këtë projekt, i cili ka mbledhur në një ekip arkitektë dhe historianë, që kanë filluar tashmë punën dhe që ne duam ta finalizojmë të paktën në fazën e projektit brenda vitit 2019 dhe më pas të ndërtojmë operacionet financiare.

Të njëjtën gjë po bëjmë edhe me Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura ose ashtu siç jemi mësuar ta njohim me emrin e vjetër institucional, Galeria Kombëtare e Arteve, që megjithë jetën artistike dhe edukative shumë të rëndësishme që ka pasur në vitin 2018, ka nevojë për ndërhyrje, për rehabilitim dhe për të rindërtuar kushtet e domosdoshme, që duhen për të ruajtur vlerat artistike dhe muzeale të jashtëzakonshme, që ka ai institucion.

Nëse mund të bëj vetëm një prezantim të projektbuxhetit në 2-3 shifra krahasuese: në vitin 2013 të ardhurat nga vizitorët (për të kuptuar se si është rritur trendi dhe pse i kemi hedhur në buxhet) janë 61 milionë lekë të ardhura, ndërsa në vitin 2018 të ardhurat nga vizitorët janë 206 milionë lekë të ardhura. Kur flas për vitin 2018, nuk është i gjithë viti, por janë nga 1 janari 2018 deri më 30 shtator 2018. Shifrat flasin vetë.

Një zë i rëndësishëm në programin e buxhetit të MK-së është ai i shpenzimeve për projekte kulturore ose zëri 604, i cili është një zë specifik që u dedikohet projekteve kulturore artistike qoftë atyre që realizohen nga institucionet e varësisë së MK-së, qoftë ato që realizohen nga skena e pavarur.

Institucionet e varësisë së MK-së në bashkëpunim edhe me subjektet e artit kanë realizuar nga 1 janari 2018 deri më 30 shtator 2018, 900 produksione kulturore, shfaqje teatrore, koncerte, panaire, festivale, ekspozita e me radhë, të cilat arritën të grumbullojnë atë numër të madh vizitorësh që prezantova pak më parë. Vetëm në art dhe kulturë kemi 370 mijë spektatorë, pa folur për atë numër vizitorësh që prezantova pak më parë në institucionet e trashëgimisë kulturore.

Padyshim, prioritet për vitin e ardhshëm do të mbetet programi i thirrjes së hapur për projekte të pavarura. E kemi nisur këtë program në vitin 2014 dhe përfitoj nga rasti të ndaj sërish me ju këtë informacion që më 1 dhjetor 2018, ne do të hapim thirrjen për projektet për vitin 2019 në fushat art, kulturë, trashëgimi kulturore, edukim përmes kulturës, i cili do të jetë edhe këtë vit një prioritet i rëndësishëm, sepse ne kemi shpallur prioritet kombëtar të qeverisë.

Edukimi përmes kulturës, që tashmë është futur si linjë programi në të gjitha institucionet tona, duam ta nxisim edhe në projektet e pavarura, sepse kemi nevojë që numrin e madh të të rinjve që kemi që t'i edukojmë me shijen e të bukurës dhe me kulturën dhe kështu, të sigurojmë edhe publikun e të nesërme. Kjo nuk ndodh, nëse ne kujtohem për publikun dhe për edukimin kulturor, kur shkojnë 40 vjeç, se aty e ka marrë ferra uratën. Njeriu nuk lexon për herë të parë libra në moshën 40-vjeçare. Ka vetëm probleme dhe nuk shkon 40 vjeç në teatër, sepse nuk e ka mësuar njeri më parë. Ne do t'i dedikohemi brezit të ri, fëmijëve duke filluar nga çerdhet, kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare.

Edhe Lëvizja Kombëtare për Lexim që ne e njoftuam nga Kukësi e do ta vazhdojmë të shtunën në Gjirokastrë dhe do ta shtrijmë deri në maj në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, sidomos në qytetet periferike, të cilat kanë nevojë për jetë kulturore, Lëvizja Kombëtare për Lexim do të shtrihet në to dhe unë do t'ju bëja ftesë t'i bashkoheshit, sepse kjo është vërtet një emergjencë kombëtare.

Për sa u përket investimeve në fushën e artit dhe të kulturës, mbyllëm me sukses në këtë vit investimin në qendrën e re kulturore ArtTurbina me vlerë 465 milionë lekë, si dhe do të vazhdojmë me avancimin e punimeve për rikonstruksionin e Teatrit Operës dhe Baletit (Investim me vlerë totale 1,1 miliardë lekë) punime, të cilat kanë avancuar me ritme të larta, ku është realizuar deri në tetor 2018 vlera prej 336,4 milionë lekë). Synojmë që punimet në këtë institucion të mbyllet brenda vitit 2019. Trupa e TOB-it do të kthehet në shtëpinë e vet në mënyrë më dinjitoze.

Duke i falënderuar 260 artistët dhe stafin mbështetës të TOB-it për një aktivitet të jashtëzakonshëm, që ndonëse “pa shtëpi”, kanë qenë në pararojë jo vetëm të kalendarit turistik, por edhe të kalendarit gjithëvjetor.

Nëse dëshironi t’ju përmend në mënyrë më specifike edhe të tjera objekte, të cilat kanë qenë pjesë e rrjetit të kantierëve në objektet e trashëgimisë kulturore, përveç atyre që përmenda në kuadër të Vitit të Skënderbeut janë:

Restaurimi i kishës së Shën Apostujve në Hoshtevë, Zagori;

Restaurimi i kishës së Shën Thanasit në Leshnicë-Sarandë. Ndërhyrjet në proces konsistojnë në konservimin dhe konsolidimin e pjesës së mbetur të Kishës pas tërmetit të vitit 2017.

Kemi realizuar edhe disa operacione të tjera shpëtimi:

- restaurimi i urës së Kordhocës në Lazarat, Gjirokastrë;
- restaurimi i urës së Nivanit, në Zagori, Gjirokastrë;
- restaurimi i Urës së Golikut në Mokër;
- restaurimi i urës së Katiut në Bënjë të Përmetit, si dhe mbaroi restaurimi i kishës së Shën Mërisë në Bënjë të Përmetit, restaurimi i kishës së Shën Mërisë në Kosinë.

Vazhdon puna në 5 kantiere për restaurimin e 5 xhamive me vlerë të madhe të trashëgimisë kulturore: Xhamia e Ethem beut në Tiranë, që do të zgjasë rreth 2 vjet, sepse është restaurimi i parë i plotë, që i bëhet këtij objekti deri në detajet artistike. Janë 2 xhami në Berat, Xhamia e Beqarëve dhe Teqeja e Helvetive.

Gjithashtu, është duke u restauruar Xhamia e Pazarit në Gjirokastrë dhe Xhamia e Gjin Aleksit në Rusanë të Delvinës.

Nëse dëshironi të hyj në detajimet e institucioneve, që janë në varësi të MK-së, mund ta bëj.

Më thoni, zonja zëvendëskryetare, nëse dëshironi të vijojmë me pyetje konkrete.

Milva Ekonomi – Shoh se pjesa e investimeve dhe e shpenzimeve rrjedhëse që ju dhatë për ministrinë, përfshin edhe institucionet e varësisë. Ndërkohë, ndarja e buxheteve është një negociim që ju keni bërë me ta, duke i ftuar të jenë prezentë në takimet që ju keni organizuar në ministri për projektbuxhetin e vitit 2019.

Mirela Kumbaro – Shumë e saktë. Në fakt, po.

Shifrat e buxhetit që unë prezantova janë totali, ku përfshihen të gjitha institucionet e MK-së, nga TOB-i deri te muzetë, drejtoritë rajonale në të gjithë territorin dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Sigurisht, detajimi është bërë në ministri, në negociim me institucionet e varësisë. Mendova që nëse ju duhen edhe këto të dhëna, unë i kam paraprakisht.

Milva Ekonomi – Zonja Ministre, mbase mund t’ju sjellim një kërkesë për një informacion më të detajuar me shkrim për këtë çështje.

Unë mendoj se shpjegimi ishte i mjaftueshëm, që ne të kalojmë në pyetje, nëse ka pyetje për zonjën ministre.

Shoh se kanë pyetje Fadili, Ismeti, Bujari. Vilma a keni ndonjë pyetje?

Fillojmë me radhë pyetjet!

Urdhëroni, Fadil!

Fadil Nasufi – Unë dua ta falënderoj zonjën Kumbaro për paraqitjen e detajuar që i bëri projektbuxhetit të Ministrisë së Kulturës për vitin 2019.

Faktikisht, në buxhetet tradicionale kultura renditej e fundit edhe nga pikëpamja e financave, edhe nga pikëpamja e hierarkisë. Në këto vite ka ndryshuar gjithçka jo falë parave, por falë vizionit dhe falë vëmendjes së Kryeministrit, si dhe asaj fytyre, atij personifikimi që i ka dhënë vetë ministrja kësaj ministrie.

Tani kemi lajme, produkte pune, promocione, ndërgjegjësim, vëmendje, pasaportë kombëtare dhe ndërkombëtare të kulturës dhe një përfitueshmëri të publikut jo vetëm në investime, por në gjithë atë ç’ka mbulon kultura dhe për këtë, meriton falënderime se, në fund të fundit, tranzicioni dëmtoi më shumë se çdo gjë tjetër asetet e trashëgimisë, vlerat e kulturës, vlerat e historisë. Turravrap i tranzicionit e la jashtë vëmendjes kulturës. Ne jemi dëshmitarë të asgjësimit të shumë vlerave kombëtare dhe të një mënyre jetese, ku qendrat e banimit ishin konvikte të mëdha pa jetë kulturore, pa monumente, pa prezencë kulturore.

Vizioni i kësaj qeverie me projektet e Rilindjes Urbane, që janë modeluar nëpër qytete dhe po vazhdojnë edhe në fshatra, po fusin pikërisht elementin e kulturës dhe të institucioneve kulturore në fshat, por kjo është një sfidë shumë e madhe, e cila nuk mund të përmbushet me kaq financa sa ne kemi.

Një tjetër lajm i mirë është fakti që institucionet e kulturës po gjenerojnë të ardhura nga prezenca e vizitorëve dhe e turistëve. Kjo jo vetëm e rrit fluksin e vizitave të vlerat kulturore dhe të pasuritë e trashëgimisë kulturore që kemi ne edhe në aspekt të rritjes së turizmit, por edhe në gjenerimin e të ardhurave për të gjetur burime financiare për të bërë restaurimet dhe për të vitalizuar objektet e trashëgimisë, që janë aq të nevojshme dhe kërkojnë shumëfishin e buxhetit që është planifikuar.

Në fakt, lajm i mirë është edhe prezenca e shumë aktorëve dhe donatorëve të tjerë, si Fondi Shqiptaro-Amerikan, Agjencia Turke për Zhvillim, BB-ja etj., të cilat kanë bërë investime kapitale dhe transformime rrënjësore në Tiranë, në Gjirokastrë, në Berat, në Korçë, në Shkodër etj. dhe tani po fillojnë në Vlorë. Këto janë modele zhvillimi të qëndrueshëm, që duhen përshëndetur dhe duhen inkurajuar për të vijuar edhe në fusha të tjera.

Ministria i përmendi shifrat dhe trendin në rritje të të gjithë treguesve. Unë jam mbështetës i atyre prioritetëve që institucionet kombëtare të kulturës që nga TOB-i, Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu Kombëtar i Skënderbeut në Krujë apo edhe Teatri Kombëtar, për të cilin kemi bërë shumë debate këtu, duhet të jenë investime elitare, sepse janë objekte të shënuara kombëtare, ku, duam apo s' duam, jo vetëm për ata që janë të apasionuar pas kulturës, por, në fund të fundit, ato përfaqësojnë identitetin e një kombi, sepse janë objekte që japin, si të thuash, të veçantën e tyre gjatë prezantimit si institucione. Prandaj, shumë mirë që mbështeten me buxhete dhe që do të kthehen në institucione dinjitoze për vendin.

Por kemi edhe shumë objekte në gjendje emergjence. Vetëm në Berat janë 38 objekte të trashëgimisë të kategorisë së parë në gjendje emergjence, të cilat nuk mund të presin këtë trend investimesh apo këtë radhë liste për të dalë nga rreziku.

Kështu, unë jam në 2 pozicione këtu: në pozicionin e anëtarit të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, por jam edhe në pozicionin e deputetit të Beratit, që është epiqendra e kulturës kombëtare dhe e trashëgimisë kulturore, i cili falë qytetarisë së vet dhe falë mundësive që i kanë dhënë donatorët dhe ministria, ka mbijetuar më mirë se Gjirokastra dhe se shumë qytete të tjera, në pikëpamjen e ruajtjes së objekteve.

Nuk do të jem dakord me faktin që në buxhetin e vitit 2019 nuk ka asnjë objekt të listuar për t'u investuar, në një kohë kur Gjirokastra ka të listuara 3 kisha dhe 2 ura. Teoria e lobingut të ministrave, që përqendrojnë vëmendjen te objektet e zonave të tyre, mua nuk më pëlqen shumë.

Kam edhe një vërejtje tjetër: ka filluar rajonizimi i drejtorive rajonale dhe Berati po kthehet në një qendër të nivelit të dytë, me zyra. Të gjithë po spostohen o në Korçë, o në Elbasan. Nuk e di nëse do të spostohet edhe Drejtoria e Kulturës Kombëtare të Beratit në një aneks tjetër.

Kështu, në pikëpamjen e balancimit të investimeve kapitale duhet të kemi parasysh prioritetet se, në fund të fundit, edhe ne vemi në zonat tona dhe u referohemi të gjitha llojeve të investimeve në kulturë, në infrastrukturë, në turizëm, në çështjet e trashëgimisë, në ato të

bujqësisë e me radhë. Mendoj se duhet të ketë një rajonizim më të mirë të objekteve, jo se nuk e meritojnë këto, sepse janë në emergjencë.

Ministrja tha se do të hapet panairi për 60-vjetorin e UNESCO-s në Paris. Edhe unë kam shkuar atje në vitin 2007, ku kemi çuar 32 ikona dhe jam i bindur që përsëri ikonat nga Berati dhe nga Korça do të venë, por duke qenë qytete të UNESCO-s Berati, Gjirokastra dhe Butrinti, duan më shumë vëmendje, jo thjesht 5 milionë lekë të reja që akordohen për partneritet të pjesës që jep qeveria, si bonus për këtë zonë historike.

Aktualisht, nga donatorët ka qenë në vitin 2013 ADF-ja dhe tani është TIKA me 3 objekte të institucioneve të kultit, por siç e thashë, prioritetet dhe nevojat kërkojnë një financim më të shpejtë dhe më aktiv.

Unë dua të përshëndes Fatmir Velajn dhe Gjergj Lucën, të cilët kanë bërë investime për Vitin e Skënderbeut, siç ishte rasti i vendosjes së bustit në Krajovë të Rumanisë, apo siç është rasti i vendosjes së memorialit të Skënderbeut në Elbasan nga biznesmeni Gjergj Luca. Këto personazhe, që solidarizohen dhe bëjnë me shpirt investime për kulturën dhe janë kaq të ngjizur me çështjet kombëtare, janë vlera që meritojnë mirënjohjen e komisionit tonë, por edhe të Ministrisë së Kulturës.

Edhe pse quhet Viti i Skënderbeut, në Berat unë nuk kam parë të zhvillohet ndonjë aktivitet. Kjo është përgjegjësi edhe e bashkisë së Beratit. Jeta dhe historia e Skënderbeut me Beratin është shumë e ngjizur, por nga bashkia atje nuk është organizuar asnjë aktivitet për të. Në kalendarin e këtij viti duhet të kishim më shumë përjetësime të figurës së Skënderbeut. Në fund të fundit, është shans që brezi ynë e ka fatin e kujtimit të 550 - vjetorit.

Për sa i përket përdorimit të të ardhurave të veta, deri në muajin shtator në Berat kanë ardhur 120 mijë turistë të regjistruar. Deri në dhjetor numri i tyre mund të shkojë 130-135 mijë. 74 mijë kanë qenë gjatë gjithë vitit 2017. Ky tregues është vlerë e pasurisë që përfaqëson Beratin, por edhe e menaxhimit që ka bërë Ministria e Kulturës dhe institucionet e ministrisë që janë në Berat. Të ardhurat që vijnë nga institucionet që janë atje, duhet të shpërndahen sipas një stimuli: ai që arkëton më shumë, të marrë më shumë për çështjet e investimeve apo të restaurimeve të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Sfida tjetër ka të bëjë me fshatrat turistike, që nuk e di si do të përcaktohen. Deri tani kemi vetëm certifikimin e 100 fshatrave. Dimë që janë përfshirë disa institucione: Ministria e Kulturës, e Turizmit, e Infrastrukturës, e Bujqësisë, ka edhe partneritete nga donatorë dhe sipërmarrës privatë, por, në fund të fundit, koha e deklaramit që janë zgjedhur 100 fshatra ka kaluar dhe sot kemi vetëm tabelën. Çfarë do të bëjmë konkretisht? E kemi sfidë të produktit që

do të nxjerrim nga detyrimi dhe angazhimi që kemi marrë përsipër para gjithë qytetarëve shqiptarë, prandaj duhet të nxitojmë që t'i konkretizojmë këto prioritetë.

Kështu që, unë e mbështes në tërësi projektin. Megjithëse ky buxhet për kulturën ka një shtesë prej 156 milionë, që është pozitive dhe me trend rritës krahasuar me vitin 2018, është modest në krahasim me sfidat që ka Ministria e Kulturës dhe objektet që janë në emergjencë civile për investime dhe nevoja të tjera.

Faleminderit!

Mirela Kumbaro – Shumë faleminderit!

Po jap një përgjigje të drejtpërdrejt për shqetësimin tuaj për Beratin. Ndoshta nuk e keni të plotë informacionin, megjithëse keni një drejtor rajonal shumë aktiv për hir të së vërtetës, të cilin do ta quaja pa frikë një amvisë të punës së vetë, sepse jo vetëm tre objektet e kultit janë kantiere restaurimi në Berat. Të mos harrojmë që Berati, së bashku me Gjirokastrën, Përmetin dhe Sarandën, është pjesë e katër qendrave që janë përfshirë në programin e madh prej 71 milionë dollarësh që ne kemi me Bankën Botërore. Berati është stacioni i parë ku ka filluar zbatimi i këtij projekti. Rruga “Mihal Komneno” dhe lagjja “13 shtatori” kanë qenë kantiere. Lajmi i mirë është që, megjithëse qendrën historike të Beratit e kishim kthyer në kantier, turizmi nuk u ndal, turistët ishim shumë mirëkuptues dhe shifrat ishin befasuese ndonëse ishim në punë e sipër.

Tabja, një nga stacionet ku ndalen të gjithë turistët, ju e dini më mirë se unë, është pjesë e këtij kantieri. Përveç kësaj, gjatë gjithë kohës kemi ndërhyrë në mirëmbajtje të objekteve private.

Meqenëse po flasim për objektet private është mirë të sqarojmë diçka. Po marr si shembull Gjirokastrën, Beratin, Korçën dhe Shkodrën meqenëse janë qendrat historike ku përqendrimi i objekteve pronë private është më i madh se kudo tjetër në Shqipëri. Nëse do t'i mësojmë pronarët e objekteve private, që janë pronarë të trashëgimisë kulturore, që çdo ndërhyrje dhe mirëmbajtje ta presim nga shteti, ne kemi firmosur të gjithë bashkë dështimin e trashëgimisë kulturore. Këtë jua them si deputetë dhe njerëz të kulturës. Duhet të kuptojmë që trashëgimia kulturore është pronë kolektive dhe po aq edhe pronë dhe aset i atyre që janë pronarë privatë. Ne e mbajmë trashëgiminë kulturore me paratë e taksapaguesve shqiptarë. Në qoftë se këto para do t'i investojmë në të gjitha objektet pronë private, nuk më duket e drejtë, në raport me ata taksapagues, të cilët nuk janë pronarë të pasurive kulturore. Duhet një ndërgjegjësim shumë i madh që, në fakt, ka munguar edhe pse jemi përpjekur shumë fort ta nxisim. Një ndër synimet e ligjit të ri të trashëgimisë kulturore është që të sensibilizojmë, por

edhe të përgjegjësojmë pronarët privatë të pasurive kulturore, që duhet ta mirëmbajnë objektin dhe jo ta lënë të rrëzohet apo ta braktisin. Nëse nuk janë në gjendje, ata duhet ta tjetërsojnë, ta shesin apo t'ia japin dikujt tjetër që të investojë për ta mirëmbajtur.

Trendi i të dyja qendrave historike të UNESCO-s, Berat dhe Gjirokastrë, ku objektet private gjithmonë e më shumë po kthehen në bujtina, është e vetmja mënyrë për të shpëtuar qendrat historike të mbushura me objekte kulturore pronë private.

Nëse Berati sot është qendër akomodimi, është pikërisht për shkak të këtij trendi. Po përmend vilën “Aleksandër”, ku nuk është e lehtë të shkosh me makinë, megjithatë turistët shkojnë, sepse është karakteristike. Nëse në vitin 2013 në Gjirokastrë ishin vetëm dy hotele, sot, në booking.com janë 91 oferta akomoduese, 80% e të cilave në qendrën historike. Kjo gjë pozitive ka ndodhur gjatë 3-4 vjetëve, por duhet nxitur. Në Berat ka objekte dhe shtëpi, të cilat janë abandonuar. Pronarët janë afër, jetojnë në Tiranë, por presin të vihet alarmi që t'i rregullojë shteti. Ne jemi gati. Drejtoritë rajonale dhe konkretisht drejtoria e Beratit punon jashtëzakonisht shumë fort me pronarët. Bëjmë gati projektet, i punojmë në Institutin e Monumenteve të Kulturës, ia miratojmë dhe e gjitha kjo bëhet me shpenzimet e Ministrisë së Kulturës. Kërkojmë nga pronarët të investojnë sadopak në mirëmbajtjen e tyre. Vetëm në muajin tetor kemi punuar në dy banesa të tilla private, familjen Xali dhe familjen Meli, nëse nuk e kam gabim. Kjo punë do të vazhdojë.

Po kështu kemi vazhduar edhe me kullat. Në kohën kur ju keni qenë kryetar bashkie, zoti Nasufi, ne kemi bashkëpunuar shumë mirë. Kemi mirëmbajtur bashkë kullat e kalasë dhe rrugicat. Patëm një shkëputje të ndjeshme nga bashkia e Beratit, e cila nuk na u përgjigj. Pas një presioni të fort, më në fund u përgjigj në vitin 2018 me një investim të përbashkët në njërën prej kullave të kalasë, të cilat, i kemi gjetur të rrënuara në vitin 2013. Ju e dini shumë mirë këtë gjë. Pra, nëse do të pretendojmë që e gjithë trashëgimia kulturore të mirëmbahet vetëm me buxhetin e Ministrisë së Kulturës, mua më duket një menaxhim jo i mirë i parave publike. Në asnjë vend të botës nuk ndodh kjo. Mund t'ia dalim vetëm nëse të gjithë bashkë punojmë për të ngritur buxhetin e Ministrisë së Kulturës, për të sensibilizuar pushtetin vendor, për të ndërgjegjësuar pronarët e objekteve pasuri kulturore. Kjo është arsyeja pse na kanë mbështetur organizata ndërkombëtare, pse për të parën herë Banka Botërore e besoi qeverinë në projektin e saj në trashëgiminë kulturore dhe nënshkroi marrëveshjen për 71 milionë dollarë dhe pse CEB-i ka investuar 7 milionë euro në Dhërmi dhe Vuno, ku kemi të njëjtin problem.

Nuk e pranoj fjalinë që si deputete e Gjirokastrës e kam përqendruar vëmendjen vetëm në Gjirokastrë, sepse mund të përmend një listë të investimeve nga Dibra deri në Butrint. Në

një farë mënyre, proporcioni i investimeve shkon në proporcion të drejtë me numrin më të madh të pasurive kulturore nga një zonë në tjetrën. Kështu që, duam apo nuk duam ne, kemi më shumë pasuri kulturore në Berat, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Durrës. Po ta shikojmë hartën, këtu shkon.

Për sa i përket shqetësimit tuaj për rajonizim, Berati dhe Gjirokastra, si dy qendra të UNESCO-s, janë drejtoritë më të përqendruara se të tjerat. Drejtori të tjera, si ajo e Shkodrës e Durrësit apo e Korçës, kanë territor më të madh dhe më të rajonizuar. Për shkak se këto dy thesare të trashëgimisë sonë kulturore dhe njëkohësisht të trashëgimisë kulturore botërore janë ato që janë, ato kanë drejtoritë e tyre të dedikuara dhe do të vazhdojnë t'i kenë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka Bujari! Më pas Ismeti, Almira dhe Vilma.

Bujar Çela – E falenderoj ministren për prezantimin. Duket që është një buxhet i balancuar në mikron. Nuk lë shumë hapësira për të lëvizur, ashtu si buxheti që kemi në të gjithë sektorët e investimeve.

Dua t'i bëj thirrje Fadilit që të mos flasë më gjatë se ministrja, sepse unë nuk mora vesh gjë, megjithëse pajtohem pak me mendimin e tij që anoni pak më shumë nga qarku i Gjirokastrës.

Së dyti, kam një kërkesë fare të thjeshtë. Thonë që Skënderbeu ka kaluar edhe në Ardenicë. Ka ndodhur diçka atje. Edhe pse viti që po ikën është quajtur Viti i Skënderbeut, atje nuk është bërë asgjë. E gjithë qeveria dhe të gjithë ne që investojmë në Gjirokastrë, Berat, Dhërmi, Bylis, kemi bërë shumë gjëra për Ismetin edhe në Apoloni, kalojmë nga Lushnja, prandaj duhet ta kthejmë kokën edhe nga Ardenica. Godina ku është mbajtur Kongresi i Lushnjës, që ka marrë vendime jo pak të rëndësishme për këtë vend, është ende pronë private. Është për të ardhur keq. Mbase nuk është totalisht detyra e ministrisë së Kulturës për ta blerë këtë objekt, por e Ministrisë së Financave, megjithatë unë shpresoj që në rrugët e shpeshta që ju do të bëni në Jug, do të ktheheni ndonjë ditë edhe në Ardenicë.

Faleminderit!

Ismet Beqiri – Për të racionalizuar kohën, unë nuk do të bëj komente, sepse komentet dhe vlerësimet që bëri kolegu im, Fadili, ishin shteruese, por do të bëj disa pyetje për projektbuxhetin e paraqitur në komision nga ana e ministrisë. Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë është planifikuar 18% më pak se në vitin 2018, kurse për artin dhe kulturën 22% më shumë se në vitin 2018. Përse ka ndodhur kjo, në një kohë që veprimtaria e trashëgimisë

kulturore dhe muzetë japin gati, sikurse ju e prezantuat, 3-fishin e të ardhurave nga çdo institucion tjetër?

Së dyti, a janë të mjaftueshme kërkesat buxhetore që ju keni bërë për vitin 2019 për mbështetjen e implementimit të ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, që miratua këtë vit?

Në kërkesat buxhetore të Ministrisë së Kulturës është marrë në konsideratë edhe programi i rilindjes urbane për 100 fshatrat. Çfarë do të bëhet konkretisht në X apo Y fshat ku ka objekte dhe site të trashëgimisë kulturore? Kam parasysh fshatin Hekal në Mallakastër, pranë të cilit ndodhen dy qendra arkeologjike shumë të rëndësishme për kombin tone: Bylisi dhe Nikaia.

Për projektet e trashëgimisë kulturore jo materiale, deklaroni se në periudhën janar-shtator të vitit 2018 janë realizuar 29 projekte. Po veprimtaria e Bylis Polifonisë, që është një festival kombëtar dhe jo vetëm, pse nuk u mbështet këtë vit? Është i vetmi aktivitet kulturor dhe artistik në qarkun e Fierit dhe sidomos në Mallakastër.

Ashtu sikurse kolegët e mi ju pyetën me të drejtë për zonat e tyre, kam edhe unë një pyetje për zonën time. A janë investuar para në vitin 2018 në fushën e kulturës, artit, rinisë dhe sportit në Mallakastër? Ndaj, sugjeroj të merret në konsideratë një kërkesë e kahershme, qoftë për pallatin e kulturës në Mallakastër, në qendrën e kësaj bashkie në Ballsh, që është ku thërret kiameti, por edhe stadiumi, sepse ky ekip është në ligën e parë. Për të mos folur pastaj për investimet në qendrat arkeologjike, historike e kulturore, që kjo zonë i ka me tepriçë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Po, Almira.

Almira Xhembulla – Faleminderit, kryetare!

Do ta filloj me një falënderim për ministren dhe Ministrinë e Kulturës, për mbështetjen që dhanë për restaurimin e plotë të Muzeut të Skënderbeut në Sinë!

Shumë vetë më kanë thënë se e kemi promovuar shumë këtë investim, por mendoj që për ne, si qark, dhe për Dibrën, si bashki, ishte një investim i duhur në vitin e duhur, në Vitin e Skënderbeut, ishte edhe si një oaz në atë shkretëtirë... Nuk është mirë ta pranoj këtë gjë, por ishte një investim që me të vërtetë krijoi një impakt shumë pozitiv në qarkun e Dibrës.

Ndërkohë, edhe mbështetja që ministria jep vazhdimisht për “Odën dibrane”, si një aktivitet që bashkon trevat shqiptare... Këtë vit këtij aktivitetit iu bashkua edhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore dhe ishte një risi shumë pozitive, e cila jo vetëm gjallëroi jetën kulturore të Dibrës, por krijoi edhe një frymë pozitive, sepse mendoj se në zonat dhe qarqet e

largëta me vështirësi ekonomike, është një gjë shumë e mirë nxitja e dëshirës për promovimin e zonës, sidomos për të rinjtë.

Në fakt, ky u ngrit si shqetësim edhe nga Fadili, por desha të pyesja se si e shikon Ministria e Kulturës kordinimin me strategjinë që kemi ne për fshatrat turistike? E kuptoj që puna kryesore lidhet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por nuk e di sa është kordinuar puna edhe me ju si ministri.

Gjithashtu, po ta shikojmë jo vetëm lokalisht, por edhe në nivel kombëtar, dëgjova që keni në plan të bëni edhe një rikonstrukcion të Muzeut Historik Kombëtar, duke qenë se na është dashur ta vizitojmë jo vetëm si vizitorë, por dhe të organizojmë evente të ndryshme. Nga **organizata** dibrane, sidomos këtë vit, janë organizuar evente të rëndësishme, simpoziume, që janë bërë në kuadër të Vitit të Skënderbeut dhe mendoj që aty është e nevojshme të ketë një investim, për ta kthyer në një ndërtesë dinjitoze për atë që përfaqëson.

Më duhet të shkoj në komisionin tjetër. Këto ishin meraket kryesore që kisha.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Do t’ia jap fjalën Vilmës, më pas kam edhe unë 2 pyetje.

Edhe pak minuta do t’ju mbajmë, sepse e dimë që keni pak kohë.

Vilma Bello – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre!

Të gjithë ne që jemi këtu, dhe jo vetëm, jemi shumë të bindur, madje jemi shumë të vetëdijshëm pozitivisht se sa arritje të dukshme dhe të prekshme kanë sjellë politikat dhe sfidat e Ministrisë së Kulturës në të gjithë territorin.

Duke mos dashur të përsëris ato që thanë edhe kolegët, që kanë të bëjnë me të gjitha ndryshimet pozitive në pasuritë tona kulturore, në shfrytëzimin e tyre apo edhe në fitimin që marrim prej tyre, do të ndalesha më konkretisht në situatën në qytetin tim, në Vlorë, në të cilin vetëm këtë vit pati një rritje të ndjeshme me 20% të numrit të vizitorëve, duke e çuar numrin e tyre në rreth 40 mijë. Madje, numri i vizitorëve në Kalanë e Kaninës dhe në Orik u rrit dyfish, kjo edhe si rrjedhojë e përmirësimit të ndjeshëm të infrastrukturës, për t’iu qasur këtyre momenteve të rëndësishme kulturore. Sigurisht, këtu lind nevoja e bashkëpunimit edhe me Ministrinë e Infrastrukturës për të lehtësuar gjithë infrastrukturën për të shkuar në monumentet e tjera të kulturës, që, sigurisht, janë po aq të rëndësishme sa këto që përmenda.

Ka mjaft monumente kulturore që kanë nevojë për ndërhyrje; është ajo që theksuat ju në përparësitë e punës dhe të politikës së ministrisë.

A kemi një listë të emergjencave për ndërhyrje?

Konkretisht, do të ndalesha në tri monumentet e bashkisë së Vlorës: Kulla e Dervish Aliut, Kisha e Marmiroit dhe Kalaja e Kaninës. A janë këto monumente në listën e emergjencave?

Fillimisht do të përshëndesja atë që ju e keni quajtur dhe është përcaktuar si “Lëvizja kombëtare për lexim”, duke e cilësuar edhe si emergjencë kombëtare. Këtu do t’i rikthehesha situatës konkrete në qytetin e Vlorës, qytet që ka qenë një nga polet më të rëndësishme për leximin. Vëmendja ndaj librit dhe edukimi me librin ka qenë shumë më e madhe se tani.

Si është menduar të realizohet kjo lëvizje dhe cilat janë hapat, që në fund, kjo nuk ka asnjëherë një përfundim, të jetë një sfidë e fituar dhe të mos mbetet një sfidë politike e parealizuar?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, Vilma!

Unë kam disa pyetje.

Në komision ne jemi përgjegjës për të parë se si buxhetet parashikojnë qëndrueshmërinë e vet projektbuxhetit për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ministria juaj është caktuar përgjegjëse për objektin nr. 11, që ka të bëjë me qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme. Pyetja ime lidhet me këtë fakt. A kemi menduar ne që në qendrat tona muzeale të krijojmë akses për njerëzit me të ardhura më të ulëta, një herë në javë ose një herë në muaj?

A kemi menduar që njerëzit me aftësi ndryshe ose të kufizuar të kenë akses në muze dhe në qendrat tona historike?

Për pyetjen tjetër që kam, në fakt, duhet të ishin bërë kërkime edhe nga komisioni. Kur ne punuam për ligjin për trashëgiminë kulturore, kemi ndarë me ju edhe faktin që të ardhurat dytësore, që vijnë nga muzetë apo *sitet* e trashëgimisë kulturore, do të përdoren për të njëjtin qëllim dhe për këtë arsye do të punohej me Ministrinë e Financave, për të nxjerrë një udhëzim ose një akt normativ të veçantë, edhe pse ligji kalonte mbi kompetencën e ligjit për Buxhetin. A është punuar për këtë fakt për vitin 2019?

Ajo që doja të shtoja në fund, lidhet me vëzhgimin dhe drejtimin që i keni dhënë ju buxhetit të vitit 2019. Ne dëgjuam gjatë këtyre kohëve për investimet kapitale që keni bërë për mirëmbajtjen e *siteve* tona kulturore. Në fakt, nuk mjafton vetëm t’i nxjerrim në pah ato që kemi si trashëgimi kulturore, por në mënyrë të qëndrueshme duhet t’i bëjmë ato të vitalizuara. Prandaj, shpenzimet, nga një zë duhet të kanalizohen në një zë tjetër, sepse u ndërtuan dhe duhen mirëmbajtur për të pasur akses. Kur lexova projektbuxhetin tuaj, vura re që kjo ishte drita që kishte udhëhequr hartimin e projektbuxhetit. Dua ta përgëzoj ministrinë për këtë gjë,

sepse ka marrë përsipër jo vetëm të bëjë kujdes për investimet kapitale, por edhe për mirëmbajtjen e tyre.

Një tjetër gjë e rëndësishme, që lidhet edhe me aktivitetin e këtij komisioni, është qëndrimi që kemi mbajtur për ndërprerjen e lojërave të fatit në gjithë territorin e Republikës. Për të gjithë ata fëmijë, tek të cilët afeksioni ndaj lodrës ishte i lartë, vumë re me shumë gëzim që ju keni filluar fushata, që kanë të bëjnë me njohurinë ndaj artit dhe me projekte të tjera të angazhimit të të rinjve në fushën e artit. Edhe për këto projekte bëjmë thirrje që, herë pas here, të kemi edhe ftesa në komision, për të marrë pjesë në aktivitete.

Ndërkohë, nga një tjetër vëzhgim që kam, rezulton se Ministria e Kulturës është ajo që nxit prodhimin e artit, por artin vetë e prodhojnë iniciativat private, në të shumtën e rasteve.

Në fakt, doja të dija nëse ka një raport midis asaj që prodhojnë entet publike dhe asaj që prodhojnë iniciativat private në territorin e Republikës, që ndiqen nga ministria.

Ju faleminderit!

Këto ishin pyetjet tona.

Mirela Kumbaro – Shumë faleminderit për pyetjet!

Dua ta nis nga konstatimi që bëri Bujari për Ardenicën. Është e vërtetë, por më lejoni të theksoj që Ardenica është pa dyshim një *sit* shumë i rëndësishëm dhe, për fat, është edhe një *sit* që mbahet shumë mirë. Meqenëse ju folët për termat e emergjencës, Ardenica nuk është në listën e emergjencave, sepse për fat të mirë është një manastir, të cilin vetë priftërinjtë, por edhe banorët e zonës, e kanë mirëmbajtur dhe është një nga pikat e atraksionit.

Po të rrimë brenda zonës së qarkut të Fierit, Kisha e Shën Gjergjit dhe Kisha e Shën Kollit në Libofshë janë në një gjendje nevojtare për ndërhyrje. Kjo është arsyeja pse i kemi dhënë prioritet këtyre dy kishave brenda atij qarku.

Për pyetjen që bëri Ismeti, dua të sqaroj dy gjëra: së pari, është e vërtetë që ka një ulje, krahasuar me vitin 2018, të shifrës së investimeve në trashëgimi kulturore, shifër që në 2018-n bëri të mundur të hapnim shumë kantiere, por, nga ana tjetër, kemi 2 elemente të tjera: një rritje shumë të rëndësishme të shifrës së investimeve në programin art-kulturë, si dhe një rritje gati dyfish të shpenzimeve korente, të cilat përdoren për mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore. Pra, nuk do të thotë që trashëgimia kulturore nuk do të jetë e investuar këtë vit. Ka ndryshuar vetëm natyra. Kemi kaluar në një mirëmbajtje... Domethënë, do të rrisim në të gjitha drejtoritë rajonale, sidomos në Berat, Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër, krahasuar me 2018-n, tavanet e parave që përdoren për mirëmbajtje. Në fakt, kjo është ajo që shpëton trashëgiminë kulturore.

Megjithatë, kam një lajm shumë të mirë për Bylisin, të cilin e rikonfirmova edhe në takimin e fundit që pata personalisht me ambasadorin e Delegacionit European para pak ditësh. Në vijim të projektit të suksesshëm të rehabilitimit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë me fondet e Bashkimit European, tashmë Bylisi është në rradhë, është konfirmuar, dhe deri në fund të vitit 2018 do të mbyllet procedurat për zyrtarizmin e këtij investimi të rëndësishëm, që do të jetë edhe shumë më i madh se ai i Apolonisë, për rehabilitimin dhe rikualifikimin e plotë të Parkut Arkeologjik të Bylisit. Kjo do të jetë, pa diskutim, për vitin 2019-2020, investimi ynë më i madh në një objekt të përqendruar të trashëgimisë kulturore. Bylisi do të jetë krenaria e Mallakastrës, por, pa dyshim, do të jetë edhe krenaria e Ministrisë së Kulturës, për dimensionin e investimit dhe thellësinë e ndërhyrjes. Ne kemi përgatitur termat e referencës. Ato janë të miratuar në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve. Tashmë prej muajsh i kemi dërguar në Bruksel. Brukseli i ka miratuar dhe në 2019-n fillojnë procedurat për hartimin e projektit. Brenda këtij mandati Bylisi do të jetë, pa dyshim, një surprizë e jashtëzakonshme për gjithë trashëgiminë kulturore shqiptare. Këtë e them edhe në përgjigje të insistimit tuaj të kahershëm, tashmë prej një viti. Është një premtim i mbajtur në letra. Do të jemi bashkë për ta filluar punën në kantier.

Ismet Beqiraj – Është një lajm për të gjithë mallakastriotët dhe për të gjithë Shqipërinë. Ju falënderoj që e keni pasur në vëmendje!

Mirela Kumbaro – Besoj se kjo mbledhje ishte momenti më i mirë për ta thënë publikisht.

Për sa i përket festivalit “Bylis polifonia”, sigurisht që është një event shumë i rëndësishëm. Duke kërkuar ndjesë, por në të njëjtën kohë duke dhënë edhe një justifikim, ju thashë që në 1 dhjetor fillojnë aplikimet për projektet e ARPA-s. Ky është momenti kur bëhen aplikimet, sepse gjatë viti mund të vijnë shumë kërkesa, por kjo na çon në një keqmenaxhim të buxhetit. Nëse ne i përqendrojmë aplikimet për projekte që në fillim të vitit, madje një muaj para se të fillojë vitit, kjo bëhet pikërisht për të mirëmenaxhuar fondet. Kështu që unë do të kërkoja bashkëpunimin tuaj që shoqata të aplikojë në kohën e duhur, sepse nuk ka arsye që të mbështetet “Oda dibrane” dhe të mos mbështetet festivali i Bylisit. Pra, duhet të ndjekim procedurat dhe të respektojmë rregullat.

Sa i përket pyetjes së Almirës, po, muzeu “Kastrioti” do të ishte një destinacion i duhur në kohën e duhur. Sa i takon “100 fshatrave”, po e jap tani përgjigjen, pasi të gjithë deputetët e kishin këtë pyetje, është një program i integruar, vërtet i iniciuar nga Ministria e Bujqësisë, së cilës iu bashkua edhe Ministria e Turizmit, Infrastrukturës dhe e Kulturës. Pra, në ato fshatra

në të cilat ka një element kulturor, që mund të jetë një kishë, një shesh, një qendër historike, një urë, një rit, një festival apo çdo lloj elementi që ka të bëjë me artin dhe kulturën është i planifikuar dhe do të ketë mbështetje nga Ministria e Kulturës në vijimësi. Në qoftë se flasim në Parkun Arkeologjik të Bylisit, sigurisht që është në përfitim të fshatit Hekal dhe kjo është edhe arsyeja kryesore për të qenë e sinqertë, sepse unë personalisht kam insistuar që Hekali të jetë në këtë listë, duke ditur që po përgatitej ky investim.

Listën e plotë nuk jua them dot, sepse nuk e kam këtu, por mund t'ju dërgoj një informacion më të plotë se cila është lista e parashikuar nga Ministria e Kulturës për “100 fshatrat”, ku disa janë realizuar, disa prej tyre janë në proces, ndërsa disa të tjera do të zhvillohen më tutje.

Për të ardhur te pyetja e Vilmës, po, është e vërtetë që jo vetëm në Vlorë, por kudo, monumentet e kulturës ne i kemi të vendosura në lartësi thuajse të paarritshme, sepse janë historikisht të vendosura në maja malesh, në rrugë pa akses, në zona të abandonuara pa banorë. Dua të risjell në vëmendjen tuaj me keqardhje, që nuk ka për të më dalë ndonjëherë, se ura e Hoshtevës ishte në një zonë në të cilën aksesohet ose me këmbë në kohë të mirë ose me mushkë dhe ku shkarja e tokës, e cila vazhdon për shkak të erozionit, shkaktoi atë fatkeqësi. Unë ju siguroj që puna që bëjnë punonjësit tanë për ta mirëmbajtur këtë pjesë, është shpeshherë në kushte të paimagjinueshme. Me orë të tëra bëhet rrugë në këmbë për të çuar materialet e ndërtimit, dërrasa, siç janë Selci i Pogonit, Leshnica e Sarandës, e cila është një zonë mjaft e vështirë dhe pa banorë dhe atje ku nuk ka banorë, sigurisht edhe mirëmbajtja është më e vështirë, sepse nuk ka një vëmendje të përditshme.

Në këtë kontest nuk mund të pretendojmë që menjëherë në të gjitha zonat ku ka monumente kulture të ketë infrastrukturë, sepse qoftë edhe për shpatullat e brishta të buxhetit të shtetit tonë, i cili nuk është një shtet i pasur, infrastruktura duhet të jetë prioritet aty ku ka njerëz, ndërkohë që ne jemi të detyruar ta mirëmbajmë trashëgiminë kulturore kudo që është. Të mos harrojmë që është shtuar harta e vizitueshmërisë së pasurive kulturore në atë masë sa që halli më i madh nuk është se i shterova të gjitha, por nuk arrin dot t'i vizitosh të gjitha.

Sa i takon listës së emergjencës, kemi depozituar në vitin 2018, me kërkesë të komisionit tuaj, një listë të objekteve të emergjencës, një pjesë e tyre me përditësimin që po i bëjmë kanë dalë tashmë si pasojë e të gjitha ndërhyrjeve që janë bërë në këto 4 vjet, por mendoj që edhe për shumë kohë do të vazhdojmë të kemi një listë emergjence përderisa për 30 vjet e kemi lënë trashëgiminë kulturore të bjerë në emergjencë, prandaj nuk mund ta nxjerrim dot trashëgiminë kulturore 100% nga emergjenca për 4 vjet. Kjo nuk mund të bëhet dot në qoftë

se pritet që të bëhet vetëm nga Ministria e Kulturës, në indiferencë shumë herë të plotë nga pushtetet vendore, nga komunitetet dhe biznesi, prandaj investimet publike duhet të shoqërohen me një sensibilizim shumë të madh të të gjithë aktorëve të shoqërisë. Trashëgimia kulturore është kolektive, të gjithë duhet të krenohemi me të dhe të gjithë duhet të kontribuojmë.

Kalaja e Kaninës është pjesë e qendrës historike të Kaninës, për të cilën tashmë ka një projekt studimi dhe në dijeninë time është në prioritetet e investimit të qeverisë. Për Kishën e Marmiroit kemi hartuar projektin, të cilin e kemi gati, e kemi miratuar edhe në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve dhe duhet ndërtuar një operacion financiar në vijim. E njëjta gjë edhe për Kullën e Dervish Aliut, por mendoj që Kulla e Dervish Aliut mund të arrihet, pasi e kemi futur në listën që ua kemi propozuar sponsorëve privatë, bizneseve të ndryshme me të cilët ne kur zhvillohet një rrugë, kur bëhet një HEC apo kur kanë një investim privat është e mira të japin një kontribut dhe ne jemi përpjekur ta realizojmë këtë. Për shembull, Ura e Golikut, e realizuar nga Drejtoria Rajonale e Korçës është bërë me investim të biznesit privat, të cilin e kemi sensibilizuar për të kontribuar në trashëgiminë kulturore.

Me shumë kënaqësi jap shpjegim për “Lëvizjen Kombëtare për Lexim” dhe dua t’ju them që nuk është hera e parë që ne e bëjmë këtë. Kemi 4 vjet që zhvillojmë aktivitete të leximit dhe të edukimit të leximit, duke e quajtur fushatën “Takohemi për një libër”. Ne mendojmë se duhet t’i japim një përmasë më të gjerë dhe ta shtrijmë në kohë dhe për këtë arsye këtë vit e quajtmë “Lëvizja Kombëtare për Lexim”, e cila nisi nga Kukësi edhe për një simbolikë shumë të veçantë, për shkak të një poeti martir të poezisë, i cili është varur në vitin 1988, sepse shkruante poezi, Havzi Nela, do të vijomë në Gjirokastrë, edhe këtu për një simbolik të fortë, sepse kemi të parën grua shkrimtare Musine Kokalari, një tjetër martire e letrave dhe e mendjes së lirë. Kjo do të vazhdojë në të 12 qarqet, duke u përqendruar jo vetëm në bashkitë e mëdha, ku ne mendojmë që ka një potencial, i cili duhet të aktivizohet dhe synimi i kësaj lëvizjeje është që t’i ngacmojë të gjitha potencialet e fjetura, por edhe në qytetet e vogla siç janë Patosi, Delvina, Puka, Ballshi, Bilishti në të cilat mendojmë se duhet ta krijojmë këtë vatër edukimi.

Këtë vit “Lëvizja Kombëtare për Lexim” u dedikohet të gjithë brezave, por në mënyrë të veçantë fëmijëve, por edhe prindërve të fëmijëve të vegjël dhe kjo është arsyeja pse ne kemi përfshirë tashmë, gjë që do ta shihni edhe në javët në vijim, mbështetjen e shumë personazheve publike, të cilët jodosmosdoshmërisht lidhen me librin, por publiku i do se janë sportistë të mirë, aktorë të mirë, artizanë, mjekë të mirë, të cilët kanë pranuar të bëhen pjesë e kësaj lëvizjeje. Unë do t’ju ftoja të gjithëve, mos prisni që këtë gjë ta bëj vetëm Ministria e Kulturës, të përpiqemi që në fund të kësaj lëvizjeje të kemi 10 mijë lexues të rinj, por duhet “ta këndojmë

këtë këngë”, nëse mund ta përdor këtë shprehje paksa popullore çdo ditë në të gjitha format për të kuptuar që leximi nuk është luks, por duhet të jetë një vlerë, i cili duhet të na shoqërojë.

Unë mendoj se çdo mjet është i mirë për ta arritur këtë qëllim, prandaj ju ftoj t’i bashkoheni kësaj lëvizjeje dhe ta mbështesni Ministrinë e Kulturës në këtë fushatë masive që tashmë e kemi nisur dhe duam ta shtrijmë deri në fund të vitit shkollor.

Programi i “Edukimit përmes kulturës”, po i jap përgjigje njërës prej pyetjeve që bëri nënkryetarja e komisionit, është një program shumë i rëndësishëm. Vitin e kaluar ne patëm shumë sukses me klubet teatrale, me konkursin e koreve të shkollave 9-vjeçare, eksperiencë e harruar prej 30 vjetësh, gjë që do ta vazhdojmë dhe do ta shtrijmë më shumë, kjo është arsyeja pse të gjitha muzetë tona kanë krijuar aktivitete, si: arkeologu i vogël, miku i vogël i monumentit, për të cilat do të kërkoja kontributin tuaj si deputet që në zonat tuaja ta nxisni komunitetin të marrë pjesë dhe të mos ngelemi tek ata fëmijë, të cilët edukimin kulturor e marrin në familje dhe objektivi ynë nuk janë këta fëmijë, sepse për ta e ka kryer familja detyrën e saj. Ne si shtet dhe si institucione vendimmarrëse dhe ekzekutive kemi detyrë të mendojmë për atë pjesë të popullsisë, për të cilën në fakt mjafton të shohësh rrjetet sociale për të kuptuar se sa emergjente e kanë nevojën për edukim. Kjo nuk është shaka, nuk është batutë, nuk është as stuhi *facebook*-u, por kjo duhet të jetë puna jonë e përditshme dhe për këtë nuk kam asnjë dilemë.

Sa i takon pyetjes suaj lidhur me aksesin në sitet e trashëgimisë për kategori të veçanta, për kategoritë më vulnerabël nga pikëpamja ekonomike, ne kemi një kalendar shumë të pasur, e diela e fundit e çdo muaji është falas për të gjithë publikun në të gjitha sitet e trashëgimisë kulturore, në të gjithë muzetë në gjithë Shqipërinë. Unë do t’i ftoja edhe ato site apo muze, të cilat varen nga bashkitë të ndjekin të njëjtin model. Kemi paketën e biletave falas për nxënësit dhe me tarifë të reduktuar për studentët në masën 70%, kemi tarifën e reduktuar për pensionistët, le të themi zotërinjtë dhe zonjat në moshë të avancuar. Gjithashtu, kemi një numër shumë të madh vizitorësh për ditët e festave, kur hyrja është falas, po ta llogarisim nuk ka muaj që të mos ketë të paktën me gjithë ditën e diel dy ditë falas në këto site të trashëgimisë, por mund të ketë edhe shumë raste ku ka 4-5 ditë falas, siç janë muajt nëntor, prill, maj, ku të gjitha ditët siç janë ato të muzeve, të monumenteve, dita e diversitetit kulturor janë falas. Përveç kësaj të gjitha aktivitetet që organizohen nga shkollat në sitet e trashëgimisë kulturore me qëllime edukative kanë hyrje falas për nxënësit dhe në institucionet e artit dhe të kulturës ka shpeshherë ka aktivitete, të cilat janë të hapura për publikun, pa biletë.

Ekspozitat e përkohshme që organizohen janë të gjitha pa biletë, pra nuk jam në gjendje t’jua them menjëherë, por mund t’jua dërgoj me shkrim numrin e saktë të ditëve dhe aktivitetet që janë falas për publikun, madje janë shumë.

Sa i përket kategorisë së vizitorëve dhe të spektatorëve me veçori të veçanta fizike në të gjitha institucionet e reja që ne po ndërtojmë, në mënyrë të detyrueshme është pjesë e projektit aksesibiliteti për vizitorët e kufizuar në lëvizjet e tyre. Katër muzetë që kemi hapur e sigurojnë këtë gjë, qendra “Turbina” është i pari teatër në Shqipëri që ka të parashikuar në vendet e publikut vendet e posaçme për spektatorët, të cilët vijnë me karrige lëvizëse dhe janë në pamundësi të lëvizin me këmbë. Kjo është një risi absolute dhe ne do ta aplikojmë edhe në Teatrin e Operës dhe të Baletit, ku do t’i ftojme edhe të gjitha institucionet e tjera ta përditësojnë këtë lloj aksesibiliteti.

Gjithashtu, kemi organizuar edhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore dedikuar të verbërve, do të duhen shumë më tepër, por kur gjendesh përballë shumë prioriteteve njëherësh, megjithatë e kemi provuar në Muzeun Arkeologjik të Durrësit dhe ka pasur shumë sukses, saqë këtë ekspozitë për të verbrit ne e kemi lëvizur në vende të tjera të Shqipërisë dhe në Kosovë.

Sa u takon të ardhurave dytësore, vazhdon të mbetet një synim dhe objektiv i Ministrisë së Kulturës që të gjitha të ardhurat dytësore që dalin nga biletat, duhet t’i lihen Ministrisë së Kulturës, më saktë institucionit përkatës, atij muzeu dhe teatri që i nxjerr. Ju fola për një shifër në terma të përgjithshme rreth 2 milionë dollarë të ardhura për këtë vit, krahasuar me buxhetin e shtetit janë shumë pak, por krahasuar me buxhetet e vogla që kanë institucionet e kulturës janë shumë të rëndësishme.

Unë mendoj që buxheti i shtetit nuk humbet nëse këto para i lihen dhe nuk derdhen në thesar, ndërkohë që secili nga institucionet fiton shumë dhe nxitet për të performuar më mirë, për të shërbyer më mirë dhe për të mirëmbajtur më mirë. Nëse kemi një risi këtë vit, kjo është për t’u përmendur falë bashkëpunimit të ngushtë, shpeshherë edhe të zjarrtë me Ministrinë e Financave, për shkak të rritjes së të ardhurave nga institucionet e Ministrisë së Kulturës, kemi një rritje të tavanit të shpenzimeve korrente që vijnë si pasojë e një pjese e të ardhurave dytësore. Nuk e kemi 100%, por besoj se në qoftë se me buxhetin e vitit 2019, pas 5 vjetëve luftë, arritëm ta rrisnim këtë tavan, që nuk lëvizte asnjëherë, shpresoj që edhe me mbështetjen tuaj në vitin 2020 kjo e ardhur dytësore t’i shkojë...

Ndërkohë, ligji i trashëgimisë kulturore propozon për të parën herë krijimin e fondacioneve kulturore për sitet e trashëgimisë për të thithur edhe partnerë të tjerë. Po punojmë

për ta bërë këtë gjë me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim për Parkun e Butrintit, ku të ardhurat t'i mbeten parkut dhe të riciklohen brenda tij për të realizuar restaurimin dhe mirëmbajtjen që ka një kosto shumë të madhe në rijetësim.

Jam shumë dakord që programi i “Edukimit përmes kulturës”, do të jetë një kompensim shumë i mirë, ne e kemi nisur, por ka nevojë për mbështetje masive. Është një program, i cili nuk duhet marrë lehtë, pasi secili ka një kontribut për të dhënë, sërish përfitoj t'ju bëj thirrje për mbështetje dhe t'ju njoftoj dhe t'ju ftoj rregullisht në programet e “Edukimit përmes kulturës”, por jo vetëm në to, edhe në programe të tjera. Më lejoni t'ju them se edhe kur e kam bërë, përveç kryetares dhe Musait që e kam përballë, pjesëmarrja nuk ka qenë masive, e kam fjalën për kolegët e opozitës, të cilët ndonëse nuk flasin për kulturën nuk i kam parë të hyjnë asnjëherë në skenat e kulturës këto 5 vjet, ndërkohë që po ta kishin bërë dhe ndoshta do t'ju kishte bërë mirë për shpirtin dhe për mendjen.

Pyetja e fundit ka të bëjë nëse prodhimet kulturore vijnë më shumë nga institucionet publike apo private. Unë besoj fort që kulturën, pavarësisht se institucionet publike janë të rëndësishme, nuk e bën Ministria e Kulturës. Ministria e Kulturës ka për detyrë të prodhojë politika, mjete dhe instrumente për t'i mbështetur, sepse atë e bëjnë njerëzit e kulturës, të cilët ende sot vazhdojnë të jenë për një inerci të 40 vjetëve shtet i përqendruar, për arsye të mungesës së vizionit dhe të politikave të specifikuara në periudhën e tranzicionit, janë institucionet publike ato që prodhojnë më shumë ngjarje kulturore.

Pra, le të themi që ne kemi një kulturë ose një kalendar artistik më së shumti institucional dhe vazhdojnë të jenë më dominonte në skenën e kulturës institucionet publike, për shkak se kanë garancinë e buxheteve, për shkak se janë më të organizuar dhe më të përqendruar. Besoj se arsyeja e fortë është inercia që na shoqëron, por duhet ta pranojmë që 5 vjetët e fundit ky mekanizëm që ne kemi ngritur që është thirrja e hapur për projekte kulturore, ka bërë që nga viti në vit të kemi më shumë aplikime rreth 400 aplikime në vit, që do të thotë se ka interes, prej tyre dhe për shkak të buxheteve fitojnë 100 të tilla, por jo të gjitha janë cilësore. Duhet ta pranojmë që është rritur dhe është fuqizuar skena e pavarur, duhet ta pranojmë që ende nuk kemi një sinergji midis sektorit privat të biznesit si një ndër sponsorët kryesorë. Pra, për sa kohë ne do të kemi burim kryesor të financimit vetëm qeverinë kjo skenë do të jenë ende e dobët. Duhet të njohim rolin e disa bashkive, të cilat në 3 vjetët e fundit kanë qenë një bashkudhëtar shumë i fuqishëm, modeli i suksesit kryesor është Bashkia e Tiranës, i cili është partneri më i rëndësishëm i Ministrisë së Kulturës dhe që mënyrë të ndjeshme e ka rritur buxhetin për kulturën, Bashkia e Korçës, e cila ka një traditë, por mbi të gjitha mendoj se

është çështje vullneti. Në qoftë se kryetari i bashkisë, në qoftë se kryetari i qeverisë e konsiderojnë kulturën si prioritet, është skena e pavarur ajo që përfiton. Ky ndryshim vizioni nga jo pak bashki, por edhe nga qeveria e ka sjellë në rritje skenën e pavarur. Jemi ende herët për të folur që ajo skenë të dominojë, por unë mendoj që në përputhje me strategjinë kulturore të Ministrisë së Kulturës për vitin 2018-2025, jam e bindur se e ardhmja do të jetë e skenës së pavarur dhe kështu duhet të jetë.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Ministre!

A ka pyetje të tjera?

Bujar Çela – Unë ngul këmbë përsëri për muzeun e Lushnjës, i cili është rrjepur nga të gjitha anët. Ndërtesa e kongresit që shpalli si kryeqytet Tiranën, e cila ka 100-vjetorin pas një viti, do të jetë ende biznes i familjes Fuga apo do të jetë pronë e shtetit?

Milva Ekonomi – Zonja Ministre, faleminderit!

Ne e kuptojmë që nevoja për para është e madhe, por me këtë buxhet që ju keni për këtë vit, objektivat tuaja janë të realizueshme. Unë mendoj se ky ishte një lajm i mirë për kolegët në këtë dëgjese, si dhe intensiteti i aktiviteteve kulturore do të vazhdojë, duke u shoqëruar me disa fushata mbarëkombëtare që kanë për qëllim nxitjen e edukimit nëpërmjet kulturës.

Punë të mbarë dhe ne do të na keni gjithmonë mbështetës!

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019” me Akademinë e Shkencave dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Vasil Tole – sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave,
Xhuli Vaqarri – përgjegjëse e Sektorit të Financës në Akademinë e Shkencave,
Maringlen Verli – drejtor i Akademisë së Studimeve Albanologjike,
Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Vazhdojmë me dëgjesat, pasi kemi institucione të tjera.

Mirë se erdhët!

Na falni për vonesën, por dëgjesat për buxhetin kanë shumë impenjime!

Unë dua t'ju falënderoj për dërgimin e materialit për dëgjesën e sotme. Si përherë jeni shumë institucionalë dhe i bëni gjërat siç duhet dhe në formatin që duhet.

Kemi ndjekur këtë lloj procedure në dëgjesat për buxhetin: kanë folur përfaqësuesit e institucioneve që janë thirrur, pastaj anëtarët e komisionit kanë bërë pyetje dhe në fund kemi konkluduar nëse buxheti ka qenë i mjaftueshëm ose jo për të bërë aktivitetet. E dimë që për çdo vit buxheti për institucionet duhet të jetë më i madh, sepse objektivi që kanë drejtuesit e tyre për të bërë më shumë, për të performuar më mirë lidhet me më shumë para, por aftësia e drejtuesit është që me buxhetin pak më të lartë, të arrihet performanca më e mirë e mundshme, kështu që me këtë frymë jemi munduar të vendosim diskutimet në komision.

Zoti Vaso, fjala për ju.

Vasil Tole- Faleminderit!

Së pari, doja t'ju falënderoja, pasi javën e kaluar, falë përpjekjeve për ndërtimin e rrugëve të komunikimit mes shkencës dhe politikës, është nënshkruar një marrëveshje mes Kuvendit, Akademisë së Shkencave dhe ILA-ve private dhe publike në Shqipëri. Besoj se edhe në frymën e kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi ynë në të ardhmen do të jetë më institucional jo vetëm në raste të detyrueshme, siç është sot diskutimi i buxhetit, por edhe në evente të tjera, sipas marrëveshjes së nënshkruar.

Së dyti, nuk jemi në kushtet ligjore ose edhe emocionale të vitit të kaluar, pasi këtë vit Akademia është angazhuar fuqimisht për realizimin e reformës së saj institucionale.

Me këtë rast dëshiroj të falënderoj komisionin për mbështetjen e tij, pasi në çdo akt të reformës kemi informuar zyrtarisht pranë këtij komisioni.

Së treti, në lidhje me projektbuxhetin, ne kemi qenë në kontakt me Ministrinë e Financave dhe çojmë që niveli i buxhetit të këtij viti i përmbush detyrat kryesore për të cilat ne jemi angazhuar, si në përputhje me misionin e Akademisë, ashtu edhe në zbatim të funksioneve që ligji i ka caktuar Akademisë. Kam kënaqësinë të them që kontrollet financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Akademinë, pas auditimeve që janë bërë, kanë qenë pozitive.

Nuk po zgjatëm në çështjet e tjera, pasi janë të shkruara në materialin që ju kemi dërguar, por dy janë çështjet, të cilat desha t'i ngre këtu: së pari, në shpenzimet buxhetore për

vitin 2019 janë mbuluar në mënyrë të kënaqshme zërat kryesorë që ne kemi, pra mbështetja e veprimtarisë shkencore që lidhet me organizimin e konferencave, aktiviteteve, botimeve, revistave ose puna kërkimore shkencore, mbështetja e çmimeve, ose mbështetja e Akademisë së të Rinjve, që është një trend i ri i këtyre dy viteve të fundit.

Gjithashtu, desha të flas për mundësinë e shtetëzimit të godinës ku kryen veprimtarinë e saj Akademia e Shkencave, pra shpronësimi për interes akademik, pasi është një godinë monument kulture i kategorisë së parë dhe ne, si institucion shtetëror, paguajmë qira mujore për mbështetjen e veprimtarisë sonë. Pra, rreth 16 % buxhetit shkon për këtë çështje, kështu që mendoj që do të ishte e udhës të shikohej kjo çështje qoftë për integritetin e vlerave monumentale dhe historike që përfaqëson ajo godinë për kryeqytetin dhe të gjithë Shqipërinë, por qoftë edhe për një arsye të thjeshtë, që lidhet me pagesën që ne bëjmë për mbarëvajtjen e punës. Ne, nga ana jonë, në përputhje me ligjin për shpronësimet publike, kemi përgatitur një dosje të vlerësimit të godinës dhe mund t'ju vëmë në dispozicion, në rast se do të shikohet një hapësirë për ta hedhur këtë hap, i cili është një hap që mund të mos përmbushet brenda një buxheti, por të paktën të jetë synim për ta shpëtuar këtë godinë.

Çështja e dytë lidhet me investimet për institucionin. Në këtë vit investimi është vetëm 1 milion, ndërkohë ne kemi një kërkesë, pasi salla e Akademisë, që është një nga sallat qendrore të Tiranës për realizimin e veprimtarive jo vetëm të Akademisë, por edhe të institucioneve të tjera, ka nevojë për disa ndërhyrje të vogla, kryesisht te sistemi elektrik. Ne kërkuam nga Ministria e Financave një shtesë prej 2 milionë lekësh të rinj për këtë çështje, por nuk ia dolëm dot.

Do t'ju lutesha, zonja zëvendëskryetare, ta mbani shënim këtë kërkesë, pasi është një investim që do t'ia rrisë vlerat asaj salle. Nga ajo sallë ne nxjerrim të ardhura, në marrëveshje me Ministrinë e Financave, të cilat kalojnë për jetëzimin e godinës, pra janë para që nuk shkojnë dëm.

Këto ishin çështjet që unë kisha.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Zoti Verli, po për ju si është buxheti?

Meringlen Verli – Është e disataherë që ndodhem para jush. Ju falënderoj për mënyrën si më keni pritur në të gjitha rastet!

Unë përfaqësoj Akademinë e Studimeve Albanologjike, ku janë 80 profesorë në 4 institute: Arkeologjia, Historia, Gjuhë - Letërsia dhe Antropologjia, të cilët, në një farë mënyrë, mund të themi se quhen institucione prodhuese.

Pavarësisht se jemi brenda ligjit të arsimit të lartë dhe kemi edhe leksionet pjesë të punës sonë, por kryesisht studimi, hulumtimi, realizimi i botimeve në këto 4 drejtime është pjesa kryesore e asaj për të cilën ne punojmë. Ka disa probleme që, nëse do të na miratohej buxheti i kërkuar, na zgjidhen; shifrat ju i keni të gjitha.

Unë me pak fjalë do të ndalem në disa gjëra që lidhen vetëm me buxhetin, sepse në materialin që ju kemi dërguar, flitet edhe për çështje legislative; disa veçori tonat duhet të pasqyrohen qoftë edhe si aneks te ligji i arsimit të lartë, për të na bërë të mundur funksionimin normal.

Desha t'ju njoftoja se kemi pasur probleme gjatë këtij viti që lidhen me botime të ndryshme, në lidhje me përkujtimin e 550- vjetorit të lindjes së Skënderbeut. Në mungesë të një mbështetjeje financiare, nuk realizuam 30 botime që mendonim, por vetëm 10, sepse premtimi për pagesa për punonjësit që punuan jashtë orarit për përgatitjen e botimeve, nuk u realizua. Kjo i ftohu njerëzit. Është një gjë që lidhet me respektimin e ligjit.

Këtu nuk shtrohet çështja e pagesave, e cila, për mendimin tim, duhet parë, jo thjesht për krahasimin me Kosovën ku raportet janë 2 me 1 në pagesat e zakonshme që profesorati në Kosovë merr, por për faktin se, nëse nuk do të kihet kujdes në drejtim të studiuesve që i takojnë periudhës së mesjetës ose edhe më herët, ku duhen latinishtja, sllavishtja e vjetër, greqishtja e vjetër, osmanishtja ose latinishtja e kështu me radhë, është e qartë që ne nuk do të kemi prurje. Tani mbahemi me disa studiues të fundit që i njohin mirë këto gjuhë.

Sa u përket mënyrave të rekrutimit të rinjve, mund t'i çojmë për t'u përgatitur dhe këtu duhet një buxhet, por mund të rekrutohen edhe të përgatitur, por duke i joshur me një pagesë të arsyeshme.

Nga ana tjetër, duhet vënë dorë në përmirësimin e kushteve të punës. Ne, për fat të keq, kemi disa vjet që jemi në dy godina, njëra nga të cilat është jashtë standardeve normale, qoftë për punën e studiuesve, janë në një dhomë disa profesorë, dhe kjo nuk është normale për llojin e punës që bëjmë, qoftë edhe për ruajtjen në këto godina të arkivave tona, nga të cilat do të veçoja se me rrezikshmëri është çështja e arkivit të antropologjisë, që ka materiale në tekstil, dru e të tjera, por që, nëse nuk kanë një farë mbajtjeje normale, do të shpërbëhen shumë shpejt.

Me këtë rast dua të ngre problemin e krijimit të një instituti kombëtar antropologjik, sepse kemi pasuri të papara. Ndërkohë që shtrohet çështja e turizmit kulturor, ato materiale që kemi ne janë të mrekullueshme.

Po kështu, një dorë të re investimi do Muzeu Didaktik i Arkeologjisë, që është më i pasur se i Durrësit dhe Korçës, sepse ka gati 28 mijë objekte nga gjitha trevat shqiptare.

Gjithashtu, dua të theksoj se ne kemi përgatitur për veten tonë ish-palestrën, e cila u nda në dhoma, u bë e mundur të mendohej për një afat 20-30 vjeçar. Kërkesat tona janë të vogla; për humor po e them, çdo kush që ka hyrë, nuk e ka pëlqyer, sepse i duan më komode, por për ne janë të përshtatshme. Aty ka qenë Ministria e Integritetit, pastaj Kontrolli i Shtetit, si të thuash ka kaluar dorë më dorë, pasi na u mor ne dhe nuk po gjen një përdorues më të vyer, por, nëse do të na kthehet ne për 30 vjet, e zgjidhim problemin, sepse afrojmë në një vend arkivat dhe bibliotekën. Pra, nëse na jepet mundësia për disa investime që janë të parëndësishme për shpenzimet e shtetit, nëse zbatohet ligji për honorarët, nëse të gjitha këto së bashku bëhen ashtu siç duhet, unë jam i bindur që rendimenti do të rritet, nga 10 botime në vit kemi shkuar në 30-40 botime në vit. Synimi ynë është që një profesor, kur të dalë në pension, të ketë botuar 30 libra. Pra, kjo lidhet me zbatimin e ligjit dhe krijimin e disa kushteve që studiuesit tanë kërkojnë.

Nëse keni pyetje, unë do t'ju përgjigjem.

Milva Ekonomi- Faleminderit!

Kolegë deputetë, a keni pyetje për përfaqësuesit e dy institucioneve kërkimore?

Pra, nga të dyja institucionet kemi kërkesë për shtim fondesh për sallën e aktiviteteve tek Akademia, që është e të gjithë kërkuesve, ndërsa Albanologjia ka nevojë jo për fonde shtesë, por respektim të ligjit për fondet dhe nevojën e riorganizimit hapësinor të Institutit.

Për këtë të dytën, që nuk ka lidhje me buxhetin, është e nevojshme të sensibilizojmë Këshillin e Ministrave.

Për të parat do të bëjmë të mundur, si komision, të çojmë opinionin dhe kërkesën tonë pranë ekzekutivit.

Ismet Beqiraj - Sa i përket lajmit që na dha profesor Tole për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave, ai ka qetësuar zhurmat që u dëgjuan një vit më parë. Me gjithë atë terror mediatik, prapë profesorët e nderuar të Akademisë së Shkencave kishin shumë shpresë jo vetëm në politikat qeverisëse të kësaj maxhorance, por së bashku e kapërcyem dhe na vjen mirë sot për lajmin që sapo na e dha profesori.

Gjithashtu, ishte shumë modest edhe në kërkesa. Unë jam shumë dakord me zonjën Ekonomi dhe mbështes dhënien e një mundësie financimi për sallën e Akademisë, ku bëhen jo vetëm promovime, por shumë aktivitete të shkencës të kulturës dhe të fushave të tjera që mbulon Akademia e Shkencave. Por një gjë nuk e kuptova, kërkon vetëm restaurim për sallën?

Nuk ka kosto financiare rinovimi komplet. A ka ndonjë projekt për të pasur një Akademi bashkëkohore? A ka ndonjë faturë, apo i keni parashikuar te projektbuxheti?

Problematikat që prezantuat përfshijnë të gjithë aktivitetin e Albanologjisë, sidomos jo vetëm për kushtet që u duhen krijuar studiuesve dhe shkencëtarëve, për të cilët ju me të drejtë e thatë se janë të rrallë, por mua më shqetëson fakti lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e arkivave të ekzemplarëve që, nëse ndodh një aksident, largqoftë një zjarr, ne nuk i kemi më.

Në projektbuxhet a është parashikuar që të ndërhyhet me investime?

Bujar Çela – E vlerësoj shumë parashtrimin që bëtë nga ana juaj të projektbuxhetit të vitit 2019. Me të vërtetë akademikët janë fjalëpakë dhe punë shumë. Mbetet në vlerësimin tonë si komision që të ngremë zërin më lart për t’ju mbështetur, në mënyrë që jo vetëm të zini vendin dhe rolin, sepse atë e keni të siguruar me punë, por vlerësimi nga ministria, nga qeveria, nga vitet që rëndojnë në këtë harresë, besoj se kanë bërë punën e tyre. Unë marr shkas nga ajo që parashtoi akademiku Veli lidhur me kërkesën tij shumë të thjeshtë për ambiente pune dhe të mos mendojmë pastaj për mospagesat e honorarëve, për pagat, të cilat lenë për të dëshiruar në nivelin e vlerës suaj kombëtare. Nuk mund të mendohet që një shtet të mos ketë akademikë të shkencave, të mos ketë patentat dhe markat e tij për t’u prezantuar.

Unë shpreh bindjen dhe jam pro mbështetjes që ne, si komision, ta shikojmë këtë kërkesë, e cila më duket shumë modeste, në mënyrë që Akademia e Shkencave të ketë vendin e duhur. Pa mbështetje financiare, unë nuk besoj se Akademia e Shkencave do të ketë mundësi të bëjë shkencë, sepse është thënë prej kohësh, që para se të merresh me shkencë, art dhe kulturë, duhet të kesh kushte, ambiente, si dhe të trajtohesh nga ana financiare.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Natyrisht, kërkesat tuaja ju i keni sjellë me shkrim, por janë regjistruar edhe sot gjatë diskutimeve. Ne jemi një komision që nuk kemi përgjegjësinë direkt te buxhetit, por jemi komision për dhënie mendimi dhe mendimet tona depozitohen në Komisionin e Ekonomisë, ku fillon një negociim tjetër bashkë me Ministrinë e Financave. Kështu që detyra jonë është ta çojmë fjalën deri atje dhe ta mbështesim. Ne e kuptojmë se është e rëndësishme, por nuk jemi ne vendimmarrësit për këtë gjë.

Për dijeninë tuaj, ashtu siç keni negociuar me Ministrinë e Financave, ashtu mund të negocioni edhe me Komisionin e Ekonomisë. Ndërkohë, edhe gjykimet tona finalizohen në fund të të gjithë procesit të dëgjimit. Ne kemi filluar të mbledhim të gjitha komentet, që kanë institucionet dhe ministritë, që janë në varësi të komisionit, për të pasur një tablo të përgjithshme dhe për ta çuar në Komisionin e Ekonomisë.

Marenglen Verli – Kolegët e dhanë mendimin e tyre në drejtim të punës sonë, por dua t'ju them vetëm dy shembuj, sepse në këto 15 faqe mund të humbasë vëmendja. Nga 80 profesorët e Akademisë, gati 15 prej tyre nuk kanë një vend pune ku të qëndrojnë dhe çdo mëngjes, me çantë në krahë, vrapojnë që t'ua zënë vendin pensionistëve në bibliotekë apo në arkiv, në mënyrë që të punojnë atje, sepse nuk ka zyra për ta. Për sa i përket finalizimit të shkencës, profesorët duhet të shkojnë me shërbim në konferenca brenda dhe jashtë vendit për të vjelur materiale të reja dhe vitin e kaluar kam pasur 6 milionë e 800 mijë lekë të vjetra për 80 profesorë, që do të thotë dy ditë shërbim brenda vendit ose treçerek dite jashtë vendit. Këto janë shembujt më pikantë dhe mendova t'jua theksoja në vazhdim të fjalës së kolegëve deputetë, të cilët u treguan shumë dashamirës.

Vasil Tole – Zoti Fate, meqenëse më bëri një pyetje zoti deputet, dua t'i përgjigjem apo t'ju dëgjoj edhe juve?

Milva Ekonomi - Përgjigjuni njëherë dhe, më pas, të dëgjojmë pyetjet e tjera.

Vasil Tole - Atëherë, arsyeja pse kërkojmë financim për sallën është se ajo është pronë shtetërore. Duke qenë se është pronë shtetërore, ne jemi të qetë sepse ato investime që ne bëjmë, i mbeten përsëri shtetit.

Në rastin e godinës së Akademisë së Shkencave, siç e thashë, është pronë private dhe të gjitha fondet që mund të na japë shteti për restaurimin e saj kanë dy problematika:

Së pari, do të trajtohet si restaurim godine dhe ne duhet të vazhdojmë procedurat me Ministrinë e Kulturës.

Së dyti, në ligjin e trashëgimisë është kryesisht detyrimi i pronarëve që të merren me mirëmbajtjen dhe restaurimin godine. Prandaj, ne propozuam që të shikohet mundësia e shpronësimit për interes publik dhe duke qenë se ajo është pronë shtetërore, mund të ndërhyhet më pas me investime ashtu siç i takon, sepse është monument kulture e kategorisë së parë.

Faleminderit!

Fatmir Velaj – Dua të them diçka shumë shkurt.

Ne, si komision, edhe vitin e kaluar kur diskutuam për buxhetin, e ngritëm zërin fort për rritjen e buxhetit të Akademisë së Shkencave, sidomos për sektorin e Albanologjisë. Shqipëria nuk e ka luksin për personalite të kalibrit të tuaj, që t'i lërë në këto buxhete, sepse jeni pasuri kombëtare dhe unë ju vlerësoj shumë si personalitete të shquara të shkencave dhe të studimeve të Shqipërisë.

Është vlerë për kombin shqiptar që Shqipëria të paraqitet në institucione ndërkombëtare në mënyrë prestigjioze jo vetëm me botimet, por edhe me ambientet e saj, sepse

kur ju zoti Vaso Tole më keni ftuar në promovimet tuaja, kam parë ambientet e 60-70 vjetëve më përpara, të cilat lënë shumë për të dëshiruar.

Akademia e Shkencave është pararoja e ndërgjegjes kombëtare. Ajo bën studime të tilla, që i vijnë në ndihmë jo vetëm kombit shqiptar, por edhe Europës, në të cilën ne kërkojmë të aderojmë.

Unë jam i bindur që Ministria e Financave do ta dëgjojë kërkesën tonë, që të dyja akademive, si asaj të Shkencave dhe asaj Albanologjike, t'u rriten fondet për botimet dhe për studimet e reja, sepse, në fund të fundit, studimet nuk bëhen vetëm me arkivat që ne kemi. Për të bërë një studim të mirëfilltë, duhet të kërkohet në arkivat e Vjenës, të Stambollit, të Moskës, të Peterburgut apo në arkiva të tjera të botës, por atje kërkohen disa shpenzime, të cilat studiuesit duhet t'i kenë të garantuara, në mënyrë që botimi të mos dalë sipërfaqësor me atë material që gjendet në arkivat e shtetit shqiptar.

Shqipëria ka shumë për t'i treguar botës dhe unë jam i bindur që ju jeni në gjendje t'ia paraqisni këtë opinionit europian.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Unë dua të përgëzoj konferencën që do të bëni më 12 dhe 13 nëntor lidhur me dekorimin e profesor Frano Prendit në bashkinë e Maliqit, ku keni ftuar edhe një prej këshilltarëve të komisionit, zotin Muhamet Bela.

Faleminderit për ftesën që i keni drejtuar komisionit.

Vasil Tole – Gjatë këtij viti në fushën e historisë janë bërë disa dhjetëra konferenca brenda dhe jashtë vendit, ku me studiuesit medievistë më të mirë jemi prezantuar në disa vende të Europës, me profesor Xhufin dhe Plasarin. Gjithashtu, kemi bërë disa konferenca në vendet fqinje, ku janë të pranishëm shqiptarë, si në Maqedoni, në Kosovë dhe në Malin e Zi, dhe vazhdojmë deri në fund të vitit me konferenca të ngjashme.

Milva Ekonomi – Faleminderit dhe punë të mbarë për vitin që vjen!

Këtu e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

